REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK - OPŠTINA JUNIK – MUNICIPALITY OF JUNIK

# RAPORTI VJETOR I KRYETARIT

**Situata ekonomiko-financiare dhe realizimi i projekteve investuese**

## Janar – Dhjetor 2020

Komuna Junik
2021

TABELA PËRMBAJTJES

HYRJE ....................................................................................................4
I ADMINISTRATË E PËRGJITSHME....................................................................5
1.1 Sektorin për Administratë të përgjithshme..................................................6
1.1.1 Teknologjia Informative...........................................................................6
1.1.2 Lektori - përkthyesi i gjuhëve zyrtare.......................................................7
1.1.3 Logjistika.................................................................................................7
1.1.4 Shtëpiaku ( Mirëmbajtësi )........................................................................7
1.1.5 Rojet........................................................................................................7
1.2 Sektori i gjendjes civile ..........................................................................8-10
1.3 Sektori pritës, Protokoll dhe Arkiv........................................................10-11
1.4 Projekte të Adminstatës me impakt në shërbime cilësore...............................12

II. BUXHET DHE FINANCA ....................................................................................12
2.1 Sektori për Buxhet ...............................................................................12-14
2.2 Sektori për Financa..................................................................................14
2.3 Sektori i Tatimit në Pronë......................................................................14-17

III ZHVILLIM EKONOMIK.......................................................................................17
3.1 Sektori për zhvillim strategjik dhe turizëm.............................................17-18
3.2 Sektori për Bujqësi dhe Zhvillim Rural........................................................18
3.3 Pylltari.......................................................................................................19

IV URBANIZËM, KADASTER FHE MJEDISE.................................................................20
4.1 Seltori për Urbanizëm..................................................................................20
4.2 Sektori për kadastër.....................................................................................21

V ARSIM, KULTUR, RINI DHE SPORT ........................................................................23
5.1 Arsim...........................................................................................................23
5.2 Kultura, Rinia dhe Sporti..............................................................................25

VI SHËNDETËSI DHE MIREQENIE SOCIALE...............................................................29
6.1 Shërbimi i Shëndetit Parësor.........................................................................29
6.2 Shërbimi i shëndetit publik...........................................................................30
6.3 Shërbimet Sociale dhe Shërbimi i Kujdestarisë.............................................33
6.4 Shërbimi i Skemës së ndihmës sociale...........................................................35

VII SHËRBIMEVE PUBLIKE, ISNPEKSION, MBROJTJE DHE SHPËTIM..............................40
7.1 Sektori për Shërbime Publike dhe Inspeksion.................................................41
7.2 Sektori për mbrojtje dhe shpëtim..................................................................42

VIII ZYRA E PERSONELIT..........................................................................................49
8.1 Shërbimi i Kuvendit......................................................................................50

IX PROKURIMI PUBLIK....50

X AUDITORI I BRENDSHEM....54

SITUATA EPIDEMIOLOGJIKE DHE BALLAFAQIMI ME PANDEMIN GLOBALE COVID-19....55

LISTA E PROJEKTEVE INVESTUESE VITI 2020....56

PERFORMANCA DHE BASHKPUNIMI ME DONATOR....57

DOKUMENTET STRATEGJIKE TË MIRATUARA NË VITIN 2020....57

HYRJE

Raporti i punës për vitit 2020, paraqet aktivitetet dhe veprimtarinë e zhvilluar të Komunës së Junikut në kuadër të realizimit të vizionit dhe mandatit kushtetues e ligjor, si njësi e qeverisjes lokale në ushtrimin e funksioneve të veta me qëllim të sigurimit të një qeverisje të paanshme dhe pa dallime për të gjithë qytetarët.

Komuna me përkushtim respekton parimet e përgjithshme të Qeverisjes Lokale të përcaktuara në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, neni 123, për një qeverisje të mirë, transparente dhe efikase, në ofrimin e shërbimeve publike, gjithnjë duke respektuar Kartën Evropiane për Qeverisje Lokale.

Komuna në vijimësi mbetet në mbështetje të vizionit të saj, ku puna është e pandalshme për arritjen e standardeve dhe vlerave më të larta, integritetit, profesionalizmit, transparencës dhe llogaridhënies, ku përmes politikave zhvillimore dhe marrjes se vendimeve të rëndësishme të sigurojmë jetesën dhe mirëqenien e qytetarit.

Raporti paraqet situatën ekonomike/ financiare dhe realizimin e projekteve investuese për periudhën janar-dhjetor 2020, sipas Planit të punës së Kryetarit të Komunës për vitin 2020, i cili bazohet në Ligjin për Qeverisje Lokale dhe Statutin e Komunës.

Ky raport përbëhet nga pjesë të standardizuara të realizimit të punëve gjatë vitit 2020, të cilat pasqyrojnë aspekte të veçanta për Komunën, kompetencat dhe bazën ligjore të funksionimit të Komunës, dhe aktivitetet të cilat paraqiten sipas drejtorive përkatëse dhe zyrave të cilat funksionojnë në kuadër të Zyrës se Kryetarit.

## I.ADMINISTRATË E PËRGJITHSHME

Administrata Komunale gjatë kësaj periudhe një vjeçare ( Janar-Dhjetor 2020 ), ka qenë shumë funksionale dhe në pajtim me standardet bashkëkohore edhe përkundër situatës me pandeminë globale COVID 19, duke ju ofruar qytetarëve të saj si në aspektin kohor dhe atë cilësor realizim të te drejtave të tyre nga përgjegjësitë dhe kompetencat e komunës, me kohë maksimale të pritjes 5 minuta për të gjitha shërbimet që i ofron administrata. Në këtë drejtim fokusi ka qenë realizimi i synimeve programore, respektimi dhe zbatimi i ligjit si dhe akte të tjera juridike, të gjitha këto si parakushte për krijimin e një administrate funksionale dhe efikase, gjithmonë në shërbim të përmbushjes së kërkesave individuale dhe të përgjithshme të qytetarëve, pa asnjë dallim. Këto synime sipas planit të punës, dukshëm kanë ndikuar në ngritjen e shkallës së përgjegjësisë, disciplinës në punë, respektimit të orarit, avancim të metodës së punës, transparencë dhe efikasitetit në punë.

Në kontekst te kryerjes së shërbimeve që ofron Administrata e Përgjithshme, për këtë periudhë raportuese një vjeçare, nuk ka pasur asnjë ankesë apo vërejtje nga qytetarët tanë, që do të thotë se sipas vlerësimit të përgjithshëm Administrata i ka përmbushë obligimet e saja të parapara me Planin e Punës dhe ligjet në fuqi, në mënyrë korrekte dhe cilësore karshi qytetarëve të saj. Vlen të ceket se falë gjithë kësaj pune, angazhimi dhe përkushtimi të drejtorëve dhe gjithë stafit punues, Komuna e Junikut vazhdon të jetë ndër komunat me performancë komunale më të mirë në nivel Kosove, çmim ky i ndarë nga Ministria e Administratës së Pushtetit Lokal (MAPL).

Sfiduese për komunën e Junikut gjegjësisht Administratën ka qenë ruajtja e shëndetit të përgjithshëm, andaj bazuar në situatën e krijuar nga Pandemia Globale COVID 19 dhe në zbatim të masave të Qeverisë së Republikës së Kosovës, fillimisht muajt e pare të shfaqjes së pandemisë kemi funksionuar me sportel e pastaj kemi marrë në shfrytëzim për të gjitha institucionet publike në Komunën e Junikut, pajisjet me senzor për spërkatje të duarve me dezinfektant.

Gjatë tërë kohës është përcjell respektimi i orarit të punës, dëshmi në bazë të dhënave të nxjerra nga aparati digjital i stafit në hyrje dhe dalje si dhe kontrolli fizike në vendet e tyre të punës. Vlerësimi i punës së punëtorëve është bërë sipas kërkesës ligjore dhe në bazë të rezultateve në punë për periudhën raportuese një vjeçare (Janar – Dhjetor 2020).

Dokumentet zyrtare kanë qenë në dispozicion për qasje nga qytetarët, gjithashtu janë mbajtur takime të rregullta ditore, javore dhe mujore, takime këto që kanë sjellë ide, rekomandime dhe rezultate të mira në punë.

Drejtoria për Administratë të Përgjithshme punën e saj e organizon dhe realizon përmes sektorëve si në vijim:

- Sektorin për Administratë të përgjithshme,
- Sektorin e Gjendjes Civile,
- Sektorin për Protokoll dhe Arkiv.

## 1.1 SEKTORI PËR ADMINISTRATË TË PËRGJITHSHME

### 1.1.1 Teknologjia Informative

Zyra për Teknologji Informative përpos detyrave primare si:

- Mirëmbajta e gjithë rrjetit të Internetit në të gjitha institucionet e Komunës së Junikut,
- Regjistrimi i mbledhjet së Asamblesë komunale me kamerë dhe dërgimii në MAPL,
- Menaxhimin e fotokopjeve dhe printerëve duke mbledhur numëratorët, servisuar dhe furnizuar me toner nga kompania kontraktuese,
- Insalimin e kompjuterve të rinjë, ri-formatizimin e kompjuterëve egzistues, instalimin në bazë te rregullave të ASHI -së duke i futur në domenin RKS,
- Përcjelljes së ngjarjeve, aktiviteteve dhe manifestimeve, të cilat janë të planifikuara në komunën e Junikut,
- Dizajnimit dhe printimin e ftesave, broshurave, mirënjohjeve për nevojat e komunës dhe institucioneve tjera lokale,
- Regjistrimin e të gjitha faturave të vitit 2020 në sistemin e E-pasurisë në bashkëpunim me zyrtarin e logjistikës,

*gjithashtu ka asistuar në krijimin e bashkëpunimit të ngushtë me donator dhe përpunimin dhe dërgimin e të dhanave tek institucionet dhe donatorët përmes raporteve periodike të kërkuara si:*

- Mbledhja, verifikimi dhe dërgimi i formularëve të përformancës komunale në afatin e paraparë,
- Menaxhimin e deponive ilegale, projekt me organizatën GIZ, duke verifikuar te gjitha deponit ilegale dhe duke asistuar që ti eliminojmë ato ekzistuese, plotësimit të formularëve dhe dërgimi në ministrin e Ambientit, ku komuna e Junikut radhazi është fituese e grantit "Mjedisë i Pastër".

- Publikimin e Procedurave të Prokurimit në kohë reale sipas kërkesës së USAID, në kuadër të projektit "Komuna transaprente, efektive dhe llogaridhënëse".

### 1.1.2 Lektori - përkthyesi i gjuhëve zyrtare

Janë lektoruar të gjitha procesverbalet e Kuvendit komunal, të Komitetit për Politikë dhe Financa dhe te gjitha Komiteteve te tjera funksionale, Raportet periodike të shumë drejtorive, konkurset, rregulloret dhe të gjitha dokumentet që publikohen në faqen zyrtare të komunës.

### 1.1.3 Logjistika

Sektori i logjistikës ka realizuar regjistrimin, servisimin e të gjitha automjeteve dhe mjeteve të punës të komunës, QKMF-së, zjarrfikësve dhe pylltarëve, furnizimin me karburat dhe gjithashtu ka realizuar regjistrimin e të gjitha mjeteve të punës, invertari, pajisjeve të teknologjisë informative dhe pajisjeve tjera përcjellëse.

### 1.1.4 Shtëpiaku (Mirëmbajtësi)

Mirëmbajtja e objekteve të Komunës ka qenë e rregullt dhe në nivelin e duhur, me kohë janë lokalizuar dhe sajuar probleme të ndryshme me koste reale, gjithashtu është bërë edhe mirëmbajtja e hapësirave gjelbëruese dhe ngrohjes qendrore, ku kushtet e mira të punës kanë ndikuar edhe në përfomancën e mirë në shërbim të qytetarëve.

### 1.1.5 Rojet

Sa i përket sigurisë së objektit komunal dhe autoparkut nuk ka pasur asnjë problem gjatë kësaj periudhe raportuese një vjeçare, puna është kryer me përkushtim nga ana e rojeve dhe nuk është shfaqur asnjë shqetësim nga ana e tyre bazuar në raportet të tyre javore.

## 1.2 SEKTORI I GJENDJES CIVILE

Shërbimet i gjendjes civile ka ofruar të gjitha shërbimet e obliguara me ligj për qytetarë në mënyrë transparente e kohë reale si: plotësimi, përditësimi dhe administrimi i regjistrave të gjendjes civile, zhvillimi i procedurave administrative, mbajtja e akteve të gjendjes civile, lëshimi i dokumenteve të gjendjes civile si dhe veprimeve tjera juridike administrative në pajtim me legjislacionin në fuqi, ku sipas raporteve nga organizata ndërkombëtare komuna e Junikut sa I përketë këtyre shërbimeve ka përfomancë të shkleqyer, ku mesatarja e pritjes për marrjen e një shërbimi civil është 3-5 minuta.

| DOKUMENTET E LËSHUARA NGA SISTEMI I GJENDJES CIVILE | | | |
|---|---|---|---|
| Komuna | | Data prej | Data deri |
| Junik | | 01.01.2018 | 31.12.2018 |
| **Lloji i dokumentit :** | | | **Totali** |
| Ekstrakt nga regjistri qendror i gjendjes civile | | | 2734 |
| Certifikatë lindje | | | 1003 |
| Certifikatë martese | | | 620 |
| Certifikatë vdekje | | | 167 |
| Certifikatë vendbanimi | | | 166 |
| Certifikatë të bashkësisë familjare | | | 426 |
| Certifikatë të gjendje martesore | | | 110 |
| Certifikatë shtetësie | | | 95 |
| Lëshimi i vërtetimeve nga arkivi | | | 80 |
| Totali | | | 5401 |

Vërejtje: në këtë pjesë të raportit, përpos lëshimit të dokumenteve të gjendjes civile, numerikisht evidentohen – hyjnë në sistemin elektronik edhe verifikimet e dokumenteve të ndryshme personale sipas kërkesave të qytetarëve – palëve.

| | | | |
|---|---|---|---|
| Numri i qytetarëve që kanë kaluar në regjistrin qendror të gjendjes civile : | | | 92 |
| VEPRIMET – PROCEDURAT E ZHVILLUARA ADMINISTRATIVE: LINDJET, MARTESAT DHE VDEKJET | | | |
| Komuna | | Data prej | Data deri |
| Junik | | 01.01.2020 | 31.12.2020 |
| Lloji i dokumentit : | | | |
| Lindjet e regjistruara të rregullta dhe me vonesë, brenda dhe jashtë vendit: | | | 12 |
| Verifikime me numër personal paraprak dhe me gjenerim të numrit personal: | | | 67 |
| Rishikim lindje: | | | 07 |
| Regjistrim i Qytetarit me vendim të komisionit për shtetësi dhe me nenin 31: | | | 01 |
| Regjistrim i Qytetarit me dekret të Presidentit: | | | 00 |
| Martesat e rregullta dhe jashte vendit: | | | 54 |
| Rishikim martese brenda dhe jashtë vendit: | | | 29 |
| Shkurorëzimet: | | | 06 |
| Anulime Teknike: | | | 00 |
| Martesat me element të huaj : | | | 05 |
| Vdekjet e regjistruara të rregullta dhe me vonesë brenda dhe jashtë vendit: | | | 35 |
| Regjistrim i Qytetarit të Vdekur: | | | 06 |
| Totali : | | | |

| | | | |
|---|---|---|---|
| VEPRIMET – PROCEDURAT E ZHVILLUARA ADMINISTRATIVE : LINDJET, MARTESAT DHE VDEKJET | | | |
| Komuna | | Data prej | Data deri |
| Junik | | 01.01.2020 | 31.12.2020 |
| Lloji i dokumentit : | | | |
| Aktvendime për korrigjim të statusit dhe evidencës civile në RL.RM Dhe RV. | | | 25 |
| Kërkesa për humbje të shtetësisë së Kosovës | | | 01 |
| Kërkesa për fitimin e shtetësisë së Kosovës | | | 01 |
| Gjithsejtë kërkesa për humbje dhe fitim të shtetësisë | | | 02 |

| | |
|---|---|
| Vërtetim për verifikim të dokumentacionit për apostil | 00 |
| Kërkesat e realizuara për humbjen e shtetësisë së Kosovës | 11 |
| Kërkesat e realizuara për fitim të shtetësisë së Kosovës | 00 |
| Totali: | 38 |

Siç shihet nga ky raport, sektori i gjendjes civile ka qenë mjaft efikas dhe funksional në lëshimin e dokumenteve të gjendjes civile dhe zhvillimin e procedurave administrative për rregullimin e çështjeve të gjendjes civile sipas kërkesave të palëve.

## 1.3 SEKTORI PRITËSE, PROTOKOLL DHE ARKIV

Ky sektor ka pasur një punë intensive edhe përkundër asaj që ishte vit pandemik.

**Raporti sipas drejtorive dhe statusit të zgjidhjes**
**01/01/2020 - 31/12/2020**

| r | Përshkrimi | Pranuar | Në Proces | Miratuar | Refuzuar | Hedhur Poshtë | Pezulluar |Ceduar | Anuluar | Përfunduar | Totali |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Drejtoria e Administratës së Përgjithshme | 0 | 0 | 702 | 2 | 0 | 0 | 0 | 26 | 3062 | 3792 |
| | Drejtoria për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport | 0 | 0 | 416 | 5 | 37 | 0 | 0 | 9 | 0 | 467 |
| | Drejtoria për Buxhet dhe Financa | 0 | 0 | 1152 | 0 | 0 | 0 | 0 | 33 | 0 | 1185 |
| | Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale | 0 | 0 | 245 | 1 | 0 | 0 | 0 | 5 | 0 | 251 |

| | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| HP | Drejtoria për Shërbime Publike dhe Inspeksion | 0 | 0 | 436 | 1 | 0 | 0 | 0 | 10 | 0 | 497 |
| K | Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mjedis | 0 | 0 | 843 | 2 | 0 | 0 | 0 | 26 | 0 | 871 |
| | Zyra e Kryetarit | 0 | 0 | 763 | 1 | 0 | 0 | 0 | 24 | 0 | 788 |
| I | Drejtoria për Zhvillim Ekonomik | 0 | 0 | 365 | 0 | 0 | 0 | 0 | 2 | 0 | 367 |
| | Zyra e Kryesuesit të Kuvendit | 0 | 0 | 150 | 0 | 0 | 0 | 0 | 1 | 0 | 151 |
| | | 0 | 0 | 5122 | 12 | 37 | 0 | 0 | 136 | 3062 | 8369 |

Siç shihet nga kjo pjesë e raportit, Drejtoria për Administratë të Përgjithshme, përmes Qendrës për Shërbim me Qytetarë – Sektorit Pritës – Protokoll, ka qenë mjaftë efikase dhe funksionale në realizimin e lëndëve të përfunduara – vendosura sipas kërkesave të qytetarëve me kohë dhe brenda afateve ligjore, d.m.th. 3792 lëndë janë përfunduar sipas Ligjit të Procedurës së Përgjithshme Administrative.

Gjithashtu nivel i kënaqshëm i shërbimeve ndaj qytetarëve ka qenë edhe në Drejtoritë e tjera të Administratës Komunale që me kohë kanë përfunduar-vendosur lëndët sipas kërkesave / parashtresave të qytetarëve, ku gjatë një viti kalendarik nuk është dokumentuar asnjë ankesë e adresuar drejtë komunës sa i përketë ofrimit të shërbimeve.

## 1.4 PROJEKTE TË ADMINISTATËS ME IMPAKT NË SHËRBIM CILËSORE

Drejtoria për Administratë të Përgjithshme përpos shërbimeve administrative ka realizuar me sukses në këtë periudhë raportuese edhe disa projekte dhe aktivitete me impakt në përmirësimin e shërbimeve ndaj qytetarëve dhe krijimin e kushteve të përshtatshme për punë, si:

- Funksionalizimi i e-Kiosk-ut (i cili ofron shërbime administrative për qytetarët 24/7 ),
- Lansimi i Platformës Digjitale për Participim Publik,

Projekt i përkrahur dhe financuar nga Misioni i OSCE në Kosovë, me qëllimi të rritjes së transparencës së veprimeve qeveritare, poashtu edhe të rris pjesëmarrjen e qytetarëve në vendimmarrje.

- Ndërtimi i Qendrës për Kulturë, Turizëm dhe Agrobiznes dhe,
- Mirëmbajtja e kamerave për Siguri në Hapësirat Publike,
- "Punë praktike për student",

Përmes një memorandum bashkëpunimi në mes të Komunës së Junikut dhe Organizatës Joqeveritare Anibar, kemi mundësuar hapësirën për zhvillimin e programit të praktikës për studentët në ngritjen e kapaciteteve të tyre profesionale dhe forcimin e bashkëpunimit në mes të rinjve dhe institucioneve vendimmarrëse në nivelin lokal.

# II. BUXHET DHE FINANCA

Drejtoria për Buxhet dhe Financa bazuar në mandatin ligjor ka realizuar detyrat dhe pergjegjesitë të cilat në ketë Raport i pasqyron sipas aktiviteteve dhe punëve që janë ndërmarr gjatë periudhës vjetore janar – dhjetor 2020.

Në kuadër të kësaj drejtorie të gjitha aktivitetet janë zhvilluar konform planifikimit vjetor të punës, i cili është fryt i bashkëpunim me të gjithë stafin e kësaj drejtorie, andej objektivat e planifikuara janë përmbushur sipas aktiviteteve të zhvilluara nga sektoret si në vijim:

## 2.1 Sektori për Buxhet

Ky sekor bazuar në detyrat e punës dhe planifikimin vjetor ka përpiluar pasqyrat financiare të Komunës për vitin 2019 dhe dorëzuar në MF pas barazimit të tyre me pasqyrat e free-balancit.

- Përgaditja dhe barazimi i raportit të shpenzimeve të vitit 2019, me MF – Thesar,
- Përgaditja dhe barazimi i raportit tremoujore, gjashtëmujore, nëntëmujore dhe vjetor të shpenzimeve të vitit 2020, me MF – Thesar,

- Përpilimi i planit të rrjedhës së parasë për vitin 2020 ( cash flow ) për të gjitha programet buxhetore të Komunës Junik në bashkëpunim me Drejtoritë tjera dhe dorëzimi i tyre në Thesar MF,
- Autorizimet dhe delegimet e përgjegjësive për menaxhim dhe shpenzim të buxhetit, zyrtari zotues, zyrtaret autorizues, zyrtari certifikues, zyrtari i të hyrave – deponimi i nënshkrimeve në Thesar,
- Përgatitja e raporteve mujore dhe tremujorit të parë, tre mujorit të dytë, tremujorit të tretë dhe vjetore të,
- shpenzimeve për te gjitha programet e Komunës për vitin 2020,
- Përgatitja e raportit financiar te shpenzimeve për tre mujorin e parë, te mujorin e dytë, të tretë dhe vjetor për Komunën e Junikut për vitin 2020,
- Përgatitja e Analizës së raporteve financiare për tremujorin e parë, të dytë, të tretë dhe vjetor të vitit 2020,
- Përgatitja e raportit te punës për komplet drejtorinë për buxhet dhe financa për te gjitha sektorët për periudhën janar – mars, janar-qershor, janar-shtator, dhe janar-dhjetor 2020,
- Përgatitja e raportit sipas kodeve ekonomike për të gjitha programet e Komunës Junik për periudhën vjetore 2020.
- Përgatitja e Listës të borxheve Komunale ndaj subjekteve dhe operatorëve të ndryshëm ekonomik.
- Evidentimin dhe regjistrimin i te gjitha faturave të pranuara ne Komunën e Junikut dhe shpërndarja ne drejtoritë përkatëse
- Regjistrimi i të gjitha alokimeve mujore buxhetore konform planit vjetor të rrjedhjes së parasë së gatshme.
- Janë menaxhuar të gjitha lëvizjet e stafit në listat e pagave për të gjitha programet buxhetore komunale.
- Përgatitja e Rrjedhës se parasë (Kesh Planit) për disa projekte kapitale dhe dorëzimi i tyre ne Ministrinë e Financave dhe Transfereve përkatësisht departamentin e thesarit.
- Është përgatitur Raporti Vjetor Financiar mbi të hyrat dhe shpenzimet për vitin fiskal 2019 për Kryetarin e Komunës.
- Regjistrimi i transfereve të ndryshme nga donatoret e jashtëm sipas marrëveshjeve të nënshkruara me Komunën e Junikut.
- Mbikëqyrja e Alokimeve të të hyrave vetanake në sistemin Free-balance.
- Fillimi i procedurave për planifikimin e projekt buxhetit për periudhën buxhetore 2021/2023.
- Përpilimi i KAB-it Komunal 2021/2023 ne bashkëpunim me përgjegjësit e programeve buxhetore.
- Planifikimi i projekt buxhetit për periudhën buxhetore 2021/2023 ne bashkëpunim me te gjitha programet buxhetore.
- Janë futur në sistemin BDMS dhe PIP të gjitha të dhënat buxhetore për vitin 2021 sipas drejtorive, dhe kodeve ekonomike.

- Koordinimi i aktiviteteve për fazën fillestare te auditimit për vitin 2020 nga Auditorët e Jashtëm
- Regjistrimi i transfereve të ndryshme nga donatoret e jashtëm sipas marrëveshjeve te nënshkruara me Komunën e Junikut.
- Nisja e procedurave per planifikimin e Buxhetit per vitin 2021/2023, pas pranimit te qarkores se pare Buxhetore 2021/01 dhe te dyte.
- Perpilimi i KABI-it Komunal 2021/2023 per te gjitha programet buxhetore te Komunes Junik.

## 2.2 Sektori për Financa

- Përgatitja dhe barazimi i raportit të hyrave për vitin 2019 ne MF – Thesar,
- Regjistrimi i të gjitha të hyrave komunale në sistemin e free balancit nga të gjitha programet si psh: (Administrata, Buxhet dhe Financa, Urbanizëm, Shëndetësi, Shërbimet Publike, Zhvillim Ekonomik) varësisht nga llojet e të hyrave dhe poashtu barazimet mujore dhe dokumnet e të hyrave vetanake te cilat janë bërë ne Thesar – MF, për vitin 2020,
- Përgatitja e raporteve mujore, tremujore, gjashtemujore dhe vjetore te të hyrave për të gjitha programet e Komunës për vitin 2020,
- Zotimi i mjeteve për të gjitha programet e Komunës Junik sipas kërkesave të Drejtorive, ku gjithsejtë janë bërë 1,106 zotime ne periudhën Janar-Dhjetor 2020, ku 788 - zotime në Modulin e Aprovimeve si dhe 318- zotime në Modulin e Blerjeve, për kategoritë Mallra dhe shërbime, Komunali Subvencione, dhe Shpenzime kapitale,
- Çertifikimin dhe aprovimin e të gjitha lëndëve për pagesa të ndryshme, deri më tani janë çertifikuar - aprovuar dhe proceduar për pagesë në Freebalanc gjithsej 1,128 - lëndë të programeve dhe të kategorive të ndryshme ekonomike, ku gjithsej janë 312 - çertifikime – aprovime me Modul të Blerjes, ndërsa 816 çertifikime – aprovime me Modul të Aprovimeve. Pagesat janë bërë për kategoritë Mallra dhe shërbime, Komunali, Subvencione dhe Shpenzime kapitale,
- Shpenzimi i lëndeve gjate periudhes Jajar-Dhjetor 2020,
- Gjatë kësaj periudhe vjetore, në sistemin e Free Balancit janë bërë shpenzim këto lënd në këto module:
- Moduli i Blerejes gjithsejtë 312 lënd, ndërsa
- Moduli i Aprovimit 816 lënd.

## 2.3 Sektori i Tatimit në Pronë

Të hyrat e Tatimit mbi Pronë gjatë muajve Janar-Dhjetor 2020 janë gjithsej 61,390.79 €

Janë lëshuar vërtetime tatimore për kryerjen e obligimeve siç janë:

- *Vërtetime për regjistrim automjeteve,*
- *Vërtetime per Gjeodezi dhe Kadaster,*
- *Vërtetime për Çertifikat Vendbanimi,*

- *Vërtetime për Subvencionime*

Vërtetimet janë lëshuar kryesisht për rregullimin e dokumentacioneve të ndryshëm, ku të gjitha janë lëshuar nga sistemi me funksionin "Shtype çertifikatën e-pagesës", gjithsej janë lëshuar 919 vërtetime dhe 5 vertetime për jo tatimpagus të cilët nuk kanë pronë të regjistruar në programin e tatimit PROTAX.

ZTP ka bërë verifikimin e bizneseve se a janë aktive, ku gjithsej janë verifikuar 127 biznese ekzistuese aktive dhe janë regjistruar edhe 4 biznese të reja në sistemin e Tatimit në Pronë. Janë update-uar pikat e lokacionit tek ato Objekte të cilat pika e lokacionit ka qenë gabim, janë përditësuar mbi 240 pika.

Në muajin Shkurt 2020 janë shpërndarë fatuarat e tatimit në pronë .

| Raport mbi shpërndarjen e faturave për vitin2020 | | | |
|---|---|---|---|
| Nr i faturave | Shpërndarja | Përqindja | Mbetja |
| 1675 | 1626 | 97% | 49 |

| Numri i faturave të kthyera | | |
|---|---|---|
| 1. | Klienti nuk ka pranuar | |
| 2. | Adresa jo e saktë | 20 |
| 3. | Klienti ka ndërruar vendbanimin | 29 |
| | Gjithsej të kthyera | 49 |

Gjatë muajit Mars është hapur afatin e Ankesave 02.03.2020-02.04.2020, ku me vendim të Ministria e Financave është shtyer afati i ankesave dhe pagesave.

| Raporti i Ankesave gjate vitit 2020 | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Llojet e pronës | Gjithsejt ankesa | Ankesat e miratuara | Ankesat e refuzuara | Rritja-zvoglimi m2 | Gjithsej Efekti (- €) | Gjithsej Efekti(+€) |
| Rezidenciale | 16 | 17 | 0 | | 2879.13 | 12.62 |
| Komerciale | 1 | | | | | |
| Industriale | | | | | | |
| Rastet soc. | | | | | | |
| Garazhat | | | | | | |
| Tjera ankesa | | | | | | |
| Totali | 17 | 17 | 0 | 0 | 2879.13 | 12.62 |

Qytetarët janë informuar në kohë reale përmes Webfaqes së Komunës dhe Faqes Zyrtare në Facebook për cdo ndryshim të miratuar nga Ministria e Financave konkretisht Departamenti i Tatimit në Pronë, janë zhvilluar të gjitha aktivitetet e parapara me ligj dhe tatim paguesit me borxhe të trashëguara janë njoftuar për masat në mosfshirje të borxheve.

Sipas raportit të inspektimit nga Ministria e Financav tre rekomandimet që ka pasur ZTP nga viti 2018 i ka plotësuar të gjitha.

ZTP ka hartuar Planin e Rianketimeve të 1/5 e objekteve të cilat tatimohen për vitin 2021 dhe gjithsej janë rianketuar 296 prona, kurse në vitin 2021 do të Rianketohen lagjet "Agim Ramadani", "Gaxherr- Shalë" , "Krasniq" dhe "Gacafer", ku numri i njësisë së objekteve që do të Modifikohen është 340 njësi të objektit.

Gjatë vitit 2020 është bërë verifikimi i pronave dhe gjithsej 42 prona kanë pasur ndryshime, poashtu është bërë edhe regjistrimi i pronave të reja ku gjithsej janë regjistruar 50 prona të reja gjatë vitit 2020.

Gjatë muajit Shtator 2020 janë miratuar normat e reja Tatimore për vitin 2021 sipas Ligjit të Tatimit në pronë 06 / L-005 neni 9.

Tabela 2: Normat Tatimore sipas kategorisë së Pronës për vitin 2021

| Kategoria e Pronës | Normat Tatimore |
|---|---|
| Për njësitë bujqësore të parcelave | 0.15% |
| Për njësitë bujqësore të objekteve | 0.15% |
| Për njësitë pyjore të parcelave | 0.15% |
| Për njësitë rezidenciale të parcelave | 0.15% |
| Për njësitë rezidenciale të objekteve | 0.15% |
| Për njësitë komerciale të parcelave | 0.15% |
| Për njësitë komerciale të objekteve | 0.15% |
| Për njësitë industriale të parcelave | 0.15% |
| Për njësitë industriale të objekteve | 0.15% |

*Lidhur me tatimpaguesit e parregullt janë kryer të gjitha procedurat administrative dhe janë në produceduré të rregullit përmbarimore.

# III. ZHVILLIMI EKONOMIK

Drejtoria për Zhvillim Ekonomik, në përputhje me planin e punës dhe sipas nevojave të paraqitura gjatë procesit të punës ka realizuar aktivitete e saj me perkushtim maksimal, me pikësynim realizimin e objektivave të drejtorisë.

Drejtoria për Zhvillim Ekonomik operon me 6 punëtor të ndarë në dy sektorë funksionale:

- **Sektori për Zhvillim strategjik dhe Turizëm,**
- **Sektori për Bujqësi dhe Pylltari.**

## 3.1 Sektori për zhvillim strategjik dhe turizëm

Drejtoria për Zhvillim Ekonomik pavarësisht situatës epidemiologjike bazuar në prioritete e drejtorisë për zhvillim strategjik dhe turizëm, ka vazhduar angazhimin e mirë dhe bashkëpunues me organizata vendore dhe ndërkombëtare, si me KFOR-in italian (CIMIC) për mundësitë e mbështetjes financiare për projekte te ndryshme, ka vazhduar bashkëpunimin me organizatën ndërkombëtare të të rinjëve YMCA që vazhdon aktivitet me të rinjët në objektin e Valavicës, gjithashtu tour-operatori kroato-kanadez "Lynx Free-Ride" ka vazhduar operimin në bjeshkët e Junikut edhe gjatë sezonit dimëror 2020, të cilët kanë operuar me një Ratrak bore dhe dy helicopter, duke sjellur disa grupe turistësh për të shijuar skijimin e lire në pistë të pashkelur, ku pavarësisht masave kufizuese për mundësi udhëtimi të turistëve drejtë Kosovës sipas të dhënave të pranuara nga operatori diku rreth 500 turist ndërkombëtar kanë shijuar këtë lloj sporti gjatë sezonit dimëror në bjeshkët e Junikut.

Drejtoria për zhvillim Ekonomik gjatë vitit 2020 për shkaqe të pandemisë nuk ka organizuar aktivitete tradicionale me qëllim të promovimit të vlerave turistike siç është "Dita e Gështënjes", "Downhill Gjeravica" e aktivitete të tjera turistike, mirëpo përkundër asaj ka vazhduar zhvillimin e projekteve kapitale si: Implementimin e fazës finale të projektit "Ndërtimi i shtëpisë Bjeshkatare", "Hapja e rrugëve Fushore" ( janë hapur mbi 12km rrugë fushore), përkundër asaj që sfidë kryesore gjatë vitit 2020 ka qenë buxheti i limituar, pasiqë ka pasur rënje te të hyrave nga taksat komunale në krahasim me vitin që lamë pas si rezultat edhe i Vendimit Komunal për lirim të gjitha biznese të cilat i kryejn obligimet për vitet paraprake nga taksa komunale për vitin 2020, si masë lehtësuese në koha pandemie për bizneset lokale.

**Faturimi i përgjithshëm për vitin 2020 është 13,975.00 €**

Totali i përgjithshëm i të hyrave nga taksat komunale për ushtrim te veprimtarisë për vitin 2020 janë: 4,126.00€.

Ndërsa borxhi i përgjithshëm i vitit 2020 duke përfshirë edhe vitet paraprake 47,241.00 €

**Borxhi i falur nga Komuna ndaj bizneseve për vitin 2020 është 6,535.00 €**

## 3.2 Sektori për Bujqësi dhe Zhvillim Rural

Meqenëse zhvillimi i sektorit të Bujqësisë është prioritet për Komunën e Junikut, Drejtoria për Zhvillim Ekonomik ka implementuar projektin "Ndërtimi i Kanaleve të Ujitjes" me gjatësi prej 1.4 km. Ky projekt ka filluar me mjete vetanake të Komunës dhe është projekt dy-vjeçar dhe vlera totale e projektit kap shumën 113,000.00 Euro.

Sektori për Bujqësi dhe Zhvillim Rural në kuadër të Drejtorisë për Zhvillim Ekonomik ka realizuar aktivitet fasinnë të përvjetshme si: trajnim, këshillim, vizita, shpërndarje të broshurave dhe informacione të ndryshme, njoftim për thirrje për grante dhe subvencione etj dhe identifikim të kërkesave dhe shqetësimeve të tyre, gjithashtu janë përcjellur aktivitete sezonale bujqësore e blegtorale.

Sektori i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural pas kërkesës së Këshillit të Kryetarëve drejt Qeverisë për lirimin e masave për fermer ka pajisur me leje për lëvizje te lirë dhe NIF pothuajse të gjithë fermerët, ku më pas zhvillmet bujqësore kanë vazhduar normalisht, pra janë planifikuar mbi **80ha** me misër kokërr dhe për silazhe, më jonxhe **5ha**, me pemë **3ha**, perime **6ha**, ku rendimenti për **1ha** ka qenë **mbi 5200kg**, e që për të mbjellurat vjeshtore janë planifikuar të mbjellën **40ha** grurë, por janë mbjellur **60ha** bazuar në rritjen e kërkesës që kanë pasur fermerët për këtë rendiment.

Sektori i Bujqsisë ka realizuar gjithashtu edhe digjitalizimin e ngastrave dhe si çdo vit tjetër përpos informimit në kohë reale ka vazhduar me asistimin e fermerëve në hartimin e projekteve dhe plotësimin e dokumentacioneve për thirrje për grante dhe subvencione.

Zhvillimet Bujqësore, interesimi për kultivim të kulturave të ndryshme gjatë vitit 2020 ishte i knaqshëm, mirëpo klima joideale dëmtoj disa sektor, pasiqë Juniku u përfshi nga vërshimet dhe breshëri dhe pësuan shumë kultura bujqësore, dëme të cila Komisioni për vlerësimin e dëmeve i ka identifikuar dhe adresuar tek Ministria gjegjëse.

Vlenë të ceket që si viteve paraprake edhe në vitin 2020 ka qenë i aplikueshëm Vendimi për lëvizje të bletarëve, ashtu siç edhe janë të informuar të gjithë bletarët e komunës së Junikut.

### 3.3 Pyllëtaria

Sektori i pylltarisë përkundër konpetencave të kufizuara gjatë tërë kohës ka monitoruar gjendjen e pyjeve të larta në Parkun Nacional "Bjeshkët e Nemuna", për të adresuar pakënaqësit tek ministria e Mjedisit, mirëpo bazuar në konpetencat që ka sektori i pylltarisë ka realizuar vizita periodike në teren/pyjet në territorin e komunës së Junikut në bashkëpunim me Inspeksionin, zyrtarë të APK-së dhe Ministrisë për të parë dhe inspektuar gjendjen e pyjeve në vazhdimësi, ku edhe me policin ka koordinuar aktivitetet për përfomancë më të mirë sa i përketë mbrojtjës së pyjeve, ku bazuar në kërkesat e pranuara për pastrimin e pyjeve janë aprovuar kërkesat për pastrimin e pronave private kryesisht afër zonave të banueshme të fshatrave Gjocaj dhe Jasiq.

Shqetësuese mbetet gjendja e parkut "Moronica", ku ka qenë objektiv kryesor për mbrojtje nga Sëmundja (Procesionarja), për çka është njoftuar edhe APK-në dhe janë adresuar edhe kërkesa tek donatorët për mbështetje në luftimin e këtij dëmtuesi shumë të rrezikshëm i njohur në populli si krimbi Moromanga me qese të bardhë, por sipas vizitave në terren edhe gjendja e Gështënjes nuk është e mirë, interesimi i qytetarëve për mirëmbajtje të Gështenjave ka rënë dhe mungesa e mirëmbajtjes po rrezikon edhe jetëgjatësin e kësaj peme druri-frutor, ndërsa më mirë qëndrojmë sa i përketë kafshëve të egra dhe diversitetit të tyre, ku bazuar në vlerësimin e pylltarit të terenit dhe shoqatës së gjahtarëve të Junikut, gjendja në përgjithësi është e kënaqshme.

Komuna e Junikut në sektorin e pyllëtarisë ka bashkëpunim të mirë me oganizatën CNVP, ku nga kjo organizatë po mbështetet në dy projekte:

- *Hartimin e planit menaxhues për pyjet e pronareve privat dhe,*
- *Hartimin e projektit për identifikimin e biomasës ne Pyjet e Komunës se Junikut*

## IV. URBANIZËM KADASTËR DHE MJEDIS

Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mjedis për periudhën dymbëdhjetë mujore të vitit 2020 ka kryer punë në përputhje me planin e punës së kësaj drejtorie për vitin 2020, statutin e Komunës së Junikut dhe ligjeve të cilat e rregullojnë veprimtarinë e sajë. Për vitin 2020, Drejtorisë për Urbanizëm, Kadastër dhe Mjedis i janë adresuar gjithsejtë 871 lëndë të cilat janë shqyrtuar nga sektori përkatës.

Sipas statutit të komunës operon me 6 punëtor, të ndarë në dy sektorë funksional:

- **Sektori për Urbanizëm,**
- **Sektori për Kadastër.**

### 4.1 Sektori për urbanizëm

Në sektorin për urbanizëm janë të angazhuar gjithsejtë 3 (tre) punëtorë. Puna e tyre konsiston në respektimin e planeve të miratuara qofshin ato plane hapësinore ose plane urbane brenda territorit të komunës së Junikut, si dhe në përcjelljen e zbatimit të projekteve nga fusha e ndërtimit ku investues është komuna ose investimet janë të përbashkëta në mes të komunës dhe donatorëve të ndryshëm.

Fushës së planifikimit hapsinor i është dhënë rëndësia e merituar, prandaj edhe ka hartu një numër të konsiderueshëm planesh.

Komuna e Junikut zotëron këto plane:

- *Plani Zhvillimor Komunal,*
- *Vlerësimin e Implementimit të Planit Zhvillimor Komunal,*
- *Plani Zhvillimor Urban,*
- *Plani Lokal për Veprim në Mjedis,*
- *Plani Rregullues Urban "Qendra",*
- *Plani Rregullues Urban njësia "Gacafer dhe Pepsh", dhe*
- *Plani Rregullues Urban njësia "Krasniq dhe Bajrakatar".*

Poashtu raporti i kërkesave të parashtruara në fushën e ndërtimit është ky:

- *Pëlqim Urbanistik* 1
- *Leje Ndërtimore* 1
- *Kushte Ndërtimi* 2
- *Kushte Ndërtimi* 2
- *Çertifikate të legalizimit* 2

Punëtorët e këtij sektori po mundohen me çdo kusht që të respektohen planet e miratuara gjatë ndërtimeve që po bëhen në zona të caktuara, mirëpo edhe përkundër përpjekjeve të mëdha rezultatet nuk janë të kënaqshme.

Puna e vazhdueshme e kësaj drejtorie gjatë këtij viti ka qenë e orientuar në:

Mbikqyrje në realizimin e këtyre projekteve:

- *Hartimi I Planit Zhvillimor Komunal dhe Hartës Zonale*
- *Asfaltimi I Rrugëve Lokale*
- *Asfaltimi I Rrugës Lokale Junik - Gjocaj*
- *Rregullimi i shtratit të lumit Erenik Junik*
- *Rregullimi i hapësirave rekreative gjelbëruese rreth lumit Erenik*
- *Asfaltimi I Rrugës Junik – Gjerovicë*
- *si dhe projekte tjera në bashkëpunim me drejtorite e tjera të komunës.*

- Punimi i Projekteve, *paramasës dhe parallogarisë* si dhë përshkrime teknike për Projektet të ndryshme për nevoja të komunës.
- Ekspertët e kësaj drejtorie me sukses kanë përcjellë dhe përfunduar një varg projektesh investive të financuara nga komuna e Junikut, Ministrit dhe donatorët.

## 4.2 Sektori për kadastër

Sektorin për kadastër ka të angazhuar 2 (dy) punëtorë. Puna e tyre ka të bëjë me ofrimin e shërbimeve kadastrale palëve të interesuara, ku përveç ofrimit të shërbimeve kadastrale për palët, personeli i këtij sektori është ngushtë i lidhur edhe në ndihmën që i ofrojnë sektorit për urbanizëm në fushën e gjeodezisë, poashtu edhe në përcjelljen e projekteve investive për shkak të mungesës së punëtorëve të mjaftueshëm në sektorin e urbanizmit. Me datën 22 maj ka vdekur zyrtari i lartë për Kadaster z. Xhemë Shehu, ku përpos dhembjes për ndarjen fizike nga ne është ndjerë dhe mungesa e punës dhe kontributit të tij, ndaj punën e tij si detyrë shtesë ka vazhduar ta kryej zyrtari i ndërtimit.

Ky sektor në kuadër të drejtorisë ofron këto shërbime:

1. *Ndërrimi i kulturave kadastrale,*
2. *Ndarja e ngastrave kadastrale,*
3. *Bashkimi i ngastrave kadastrale,*
4. *Përcaktimi i kufijve të ngastrave,*
5. *Rregullimi i kufijve të ngastrave,*
6. *Dhënia e dëshmive nga baza e të dhënave tekstuale dhe grafike,*
7. *Regjistrimi i pronësisë – posedimit në bazë të transaksioneve (shitblerjeve),*
8. *Regjistrimi i pronësisë – posedimit në bazë të dokumentit për dhuratë,*

9. *Regjistrimi i pronësisë – posedimit në bazë të organeve administrative dhe gjygësore për njohjen e të drejtës së pronësisë – posedimit,*
10. *Regjistrimi i pronësisë – posedimit në bazë të pjesëtimit (ndarjes) së pronës se paluajtshme në bashkëpronësi,*
11. *Regjistrimi i pronësise – posedimit në bazë të trashëgimisë,*
12. *Regjistrimi i pronësisë në bazë të shkëputjes së bashkësisë familjare,*
13. *Regjistrimi i pronësisë – posedimit në bazë të ndërrimit (shkëmbimit) të pronës se paluajtshme,*
14. *Regjistrimi i hipotekave,*
15. *Regjistrimi i të drejtës së shfrytëzimit – qirambajtje, dhe*
16. *Punë të tjera në zyrë apo në teren sipas kërkesave të palëve, etj.*

Në formë tabelore po japim të dhënat statistikore të këtij sektori për vitin 2020:

| | |
|---|---|
| Bartja e Posedimit - Ndarje Fizike | 6 |
| Bartje e Posedimit – Blerja | 20 |
| Bartja e Posedimit – Dhurim | 13 |
| Bartja e Posedimit – Këmbim | 1 |
| Bartja e Posedimit – Trashigimi | 8 |
| Bartja e Posedimit – Akgjykim dhe fitime tjera | 0 |
| Bartja e Posedimit – Ndertim Kopenzim | 0 |
| Bashkim i Parcelave | 1 |
| Bashkim i përsonave me ID të ndryshme | 2 |
| Fshirja e Hipotekes pas skadimit të afatit | 6 |
| Modifikim i atributeve të parceles | 6 |
| Ndarje Fizike | 9 |
| Regjistrim i Hipotekes | 7 |
| Regjistrim i ngarkeses tatimore | 2 |
| Sherbimi i të dhenavë – nxerrja e certifikatave | 402 |
| Shërbimi i të dhenave – vërtetim që nuk posedon pronë | 54 |
| Krijimi i kopjeve të palnit | 180 |
| Modifikim i te drejtes se shfrytzimit | 1 |
| Modifikim i te dhenave te personit pa njes kadastrale | 4 |
| Regjistrimi i verejtjes sipas kerkesave tjera | 1 |

Përveç kërkesave në mesin e lëndëve dalëse një numër i caktuar i këtyre lëndëve është edhe njoftime me anën e të cilave është dashtë që palët apo subjektet të njoftohen lidhur me planet

e komunës ose që të njëjtat të njoftohen lidhur me procedurat ligjore për realizimin e të drejtës së tyre për parashtrim kërkese.

Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mjedis në përgjithësi i ka përmbushur objektivat e saja për vitin 2020, si në gjithë sektorët dhe drejtoritë situata pandemike ka pasur ndikim edhe në DUKM, pasiqë për një periudhë të gjatë kohore një pjesë e stafit janë detyruar që punët ti kryejnë nga shtëpia, mirëpo pavarësisht kësaj çdo kërkesë e qytetarëve është trajtuar dhe gjatë tërë kohës qytetarët kanë marrë shërbim.

DUKM ka filluar punimet në hartimin e dy projekteve të rëndësishme për komunën e Junikut "Planit Zhvillimor Komunal" dhe Hartës "Zonale për Komunën e Junikut", mirëpo për shkak të situatës ka pasur ngecje në pamundësi të organizimit të debateve me qytetarë të parapara me ligj për realizimin e këti projekti.

## V. ARSIM, KULTURË, RINI DHE SPORT

Drejtoria për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport gjatë vitit 2020 bazuar në autorizimet dhe kompetencat e dala nga ligji per Vetqeverisje Lokale dhe ligjet me te cilat rregullohet fusha e arsimit në nivel lokal ka realizuar me përkushtim planifikimin vjetor.

I gjith ky rezultat është në sajë të punës ekipore dhe bashkëpunimit të mirefilit të stafit udhëheqës e stafit profesional i realizuar sipas sektorëve vijues:

### 5.1 Arsim

DAKRS ka kryer të gjitha procedurat administrative për procedimin në divizionin e pagave në Ministrin e Financave dhe lëndeve në prokurimin publik lidhur me projektet nga fusha e arsimit dhe kërkesat për furnizim me tekste shkollore për nxënësit të shkollës filiore nga klasa parafillor e gjerë në klasën e nënte, kërkesat për regjistrimin e nxënësve në klasën e parë të shkollës fillore dhe në shkollën e mesme të lartë klasat e 10-ta, sipas afatit ligjor.

Ashtu edhe siç jemi në dijeni në mbarë vendin me vendim të Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr.01/09, Datë: 13.03.2020, në javën e dytë të muajit mars për shkak të pandemisë është ndërprerë mësimi në shkolla, ndërsa nga data 16.03.2020, Drejtoria për Arsim në bashkëpunim me drejtoret e shkollave dhe personelin arsimor me përkushtim të lartë kanë krijuar grupet me nxënësit e shkollave të Komunës së Junikut në facebook, whatsapp dhe viber

për të vazhduar mësimin me orar të rregull nga distanca në platformën digjitale Zoom, sipas plan programit të planifikuar.

Kjo Drejtori gjatë tërë kohës ka komunikuar me drejtorët dhe personelin arsimor të shkollave për të gjitha udhëzimet përmes rrjetit social facebook, duke pranuar raporte javore, mujore dhe raporte gjithëpërfshirëse të mësimit online dhe janë përcjellë në MASHT.

Në bashkëpunim me organizatën UNICEF është realizuar projekti furnizim me maska dorza dhe termometër për Arsimin fillor dhe të mesëm si masë preventive COVID-19, gjithashtu me organizatën Save the Children janë furnizuar me pako higjienike dhe materiale didaktike nxënësit e grupmoshës 3-5 vjeçare të shkollës fillore "Edmond Hoxha" në Junik, ndërsa në bashkëpunim me OSCE-në është realizuar projekti furnizim me maska për nxënësit dhe personelin arsimor në gjimnazin "Kuvendi i Junikut" në Junik.

Përkundër vështirësive procesi mësimor është realizuar dhe ka përfunduar konform planifikimit të Ministrisë së Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, dhe në vijim do të pasqyrohen informacionet lidhur me përfundimin e vitit shkollor 2019-2020.

Me datën 12.06.2020 ka përfunduar viti shkollorë për klasët 9, 10 dhe të 11, ndërsa përfundimi i vitit shkollorë për klasët e 1-të.... ka përfunduar me datën 26.06.2020.

Testi i provimit të maturës shtetërore është mbajtur me 29.08.2020, ndërsa afati i dytë është mbajtur me datën 10.10.2020 edhe pse ishte kohë pandemie maturantët treguan rezultate të mira.

Me 14 shtator ka filluar procesi mësimorë *2020/2021*, Drejtoria për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport ka bërë të gjitha përgatitjet me kohë, kështu që procesi mësimor ka nisur i rregullt në Shkollën fillore e mesme e ulët "Edmond Hoxha" në Junik dhe në Gjimnazin "Kuvendi i Junikut".

Vlenë të theksohet se me iniciativen e DKARS-së është inicuar procedura për miratimin e **"Rregullores për përkujdesjen dhe mbrojtjen e fëmijës"**

Në bashkëpunim me organizatën jo qeveritare HUMAN është realizuar projekti me nxënësit e Gjimnazin "Kuvendi i Junikut" në Junik, ku nxënësit kanë përfituar nga ligjeratat e tyre në kuadër të këti projekti është mbajtur edhe gara për Ese, me ç'rast janë shpërblyer tri esetë fituese, projekti është përmbyllur me mbjelljen e 30 fidane dekuruese në parkun e shkollës.

## 5.2 Kultura, Rinia dhe Sporti

Sektori për Kultur, Rini dhe Sport përkundër situates pandemike ka realizuar disa aktivitete në fillim vit dhe gjysëvjetorin e parë të vitit shkollor 2020-2021 si dhe aktivitete të cilat ka qenë e mundur të realizohen online.

- Është festuar dita e shkollës fillore "Edmond Hoxha ",
- Aktivitete të shumta Sportive, Kulturore dhe Rinore, me rastin e përvjetorit të rënjës së Heronjëve të Kombit "Zahir Pajaziti, Edmond Hoxha dhe Hakif Zejullahu",
- 12 vjetori i Pavarësisë së Kosovës është festuar me aktivitete të shumta të përbashkëta me Komunën e Junikut në bashkëpunim me shkollat,
- 7 dhe 8 Marsit janë kremtuar me garat e recitatorëve, garat në ping pong, si dhe një program kulturo-argëtues nga nxënësit e shkollës fillore dhe M.U." Edmond Hoxha", gjimnazit "Kuvendi I Junikut, të përkrahur financiarisht nga Komuna e Junikut;
- Biblioteka e qytetit në Junik „Dinë Mehmeti" ka punuar rregullisht në kushte pandemie duke respektur masat Anti Covit 19 dhe ju ka mundësuar lexuesve huazimin e librave sipas kërkesave dhe kapaciteteve duke përfshir edhe libra shkencor. Numri i lexuesve per vitin 2020 në Bibliotëken e qytetit në Junik „Dinë Mehmeti" është 267 lexues me 1560 libra të lexuara,
- Klubi i Atletikës "Juniku" me sukses i ka përmbyllur garat Republikane në Kosovë për vitin 2020, komuna ka arritur ti mundësojë pagesat e kuotizimit të klubit nga zyra e kryetarit të Komunës dhe financimin me karburant për pjesmarrje në gara,
- Klubi i futbollit „KF-Erenku" ka përbyllur me suksese garat rajonale në futboll, ku komuna ka mbuluar transportin për pjesëmarrje në gara,
- Klubi i Futsallit „Juniku" për arsye të pandemisë i ka ndërpre aktivitetet sportive në Mars të 2020- tës.

Vërejtje:

Shumë aktivitete kulturore dhe sportive janë anuluar për arsye të situatës pandemike.

Shtojcat:

1. Suksesi i nxënësve për vitin shkollor 2019/20 Arsimi fillor i mesëm i ulët (1-9)
2. Suksesi i nxënësve për vitin shkollor 2019 /20 Arsimi i mesëm i lartë (10-12)

*Shtojca: 01*

*Suksesi i nxënësve për vitin shkollor, 2019/20, Arsimi fillor (1-5)*

| Klasa | Nr. paraleleve | Nr. nxënëve | Suksesi pozitiv | | | | | | | | | | Gjithsej me nota të pamjaft | | Të pa notuar | | Numri i mungesave | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Shkëlqyeshëm | | Shumë mirë | | Mirë | | Mjaftueshëm | | Gjithsej me notë | | | | | | Të arsyeshme | Të paarsyeshme | Gjithsej |
| | | | Nr | % | Nr | % | Nr | % | Nr | % | Nr | % | Nr | % | Nr | % | | | |
| 1 | 3 | 47 | 24 | 51.06 | 13 | 25.53 | 8 | 17.02 | 3 | 6.38 | 47 | 100 | | | | | 237 | 4 | 24 |
| 2 | 3 | 66 | 29 | 43.94 | 17 | 25.76 | 14 | 21.21 | 6 | 9.09 | 66 | 100 | | | | | 633 | 87 | 7 |
| 3 | 3 | 55 | 33 | 60.00 | 10 | 18.18 | 9 | 16.36 | 2 | 3.64 | 54 | 98.18 | | | 1 | 1.82 | 276 | 76 | 3 |
| 4 | 3 | 52 | 30 | 57.69 | 11 | 21.15 | 8 | 15.38 | 2 | 3.85 | 51 | 98.08 | | | 1 | 1.92 | 115 | 38 | 1 |
| 5 | 3 | 66 | 40 | 60.61 | 16 | 24.24 | 7 | 10.61 | 2 | 3.03 | 65 | 98.40 | | | 1 | 1.51 | 340 | 33 | 3 |
| GJ | 15 | 286 | 156 | 54.54 | 66 | 23.08 | 46 | 16.08 | 15 | 5.24 | 283 | 98.95 | | | 3 | 1.05 | 1604 | 248 | 18 |

NOTA MESATARE (1-5) = 4,24

*Shtojca: 04*

*Suksesi i nxënësve për vitin shkollor, 2019/20, Arsimi i mesëm i ulët (6-9)*

| Klasa | Nr. paraleleve | Nr. nxënësve | Suksesi pozitiv | | | | | | | | | | Suksesi i pamjaftueshëm | | | | | | | | | | Numri i mungesave | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Shkëlqyeshëm | | Sh. mirë | | Mirë | | Mjaftueshëm | | Gjithsej me nota pozitive | | Me 1 notë të pamjaftu | | Me 2 nota të pamjaftu | | Me 3 e më shumë | | Gjithsej me nota të pamjaftu | | Të pa notuar | | Të arsyeshme | Të paarsyeshme | Gjithsej |
| | | | Nr | % | Nr | % | Nr | % | Nr | % | Nr | % | Nr | % | Nr | % | Nr | % | Nr | % | Nr | % | | | |
| 6 | 3 | 59 | 17 | 28.81 | 16 | 30.51 | 18 | 30.51 | 6 | 10.77 | 59 | 100 | | | | | | | | | | | 552 | 19 | 571 |
| 7 | 3 | 49 | 11 | 24.45 | 20 | 40.82 | 15 | 30.61 | 3 | 6.12 | 49 | 100 | | | | | | | | | | | 497 | 27 | 524 |
| 8 | 3 | 61 | 17 | 27.87 | 12 | 19.67 | 24 | 39.34 | 8 | 13.11 | 61 | 100 | | | | | | | | | | | 799 | 75 | 874 |
| 9 | 3 | 53 | 15 | 28.30 | 20 | 37.73 | 13 | 24.53 | 5 | 9.43 | 53 | 100 | | | | | | | | | | | 415 | 40 | 455 |
| GJ | 12 | 222 | 60 | 27.02 | 70 | 31.53 | 70 | 31.53 | 22 | 9.91 | 222 | 100 | | | | | | | | | | | 2263 | 161 | 2424 |

NOTA MESATARE (6-9) = 3

Shtojca: 05

Suksesi i nxënësve për vitin shkollor, 2019/20, *Arsimi i mesëm i lartë (10-12)*

| Klasa | Nr. paraleleve | Nr. nxënësve | Suksesi pozitiv | | | | | | | | | | Suksesi i pamjaftueshëm | | | | | | | | | | | | Numri i mungesave | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Shkëlqyeshëm | | Sh. mirë | | Mirë | | Mjaftueshëm | | Gjithsej me nota pozitive | | Me 1 notë të pamjaftueshme | | Me 2 nota të pamjaftueshme | | Me 3 e më shumë nota të pamjaftueshme | | Gjithsej me nota të pamjaftueshme | | Të pa notuar | | Të arsyeshme | Të paarsyeshme | Gjithsej |
| | | | Nr | % | Nr | % | Nr | % | Nr | % | Nr | % | Nr | % | Nr | % | Nr | % | Nr | % | Nr | % | | | |
| 10 | 3 | 78 | 19 | 24.4 | 21 | 26.9 | 16 | 20.5 | 15 | 19.2 | 71 | 91.02 | | | | | | | | | 7 | 9 | 819 | 406 | 1225 |
| 11 | 3 | 68 | 16 | 23.5 | 15 | 22.1 | 17 | 25 | 8 | 11.3 | 56 | 82.4 | 3 | 4.4 | 4 | 5.9 | 2 | 2.9 | 9 | 13.2 | 3 | 4.4 | 809 | 405 | 1215 |
| 12 | 3 | 53 | 15 | 28.3 | 14 | 26.4 | 16 | 30.2 | 8 | 15.1 | 53 | 100 | | | | | | | | | | | 2170 | 431 | 2601 |
| Gj | 9 | 199 | 50 | 25.12 | 50 | 25.12 | 49 | 24.62 | 31 | 15.57 | 180 | 9[illegible] | 3 | 1.50 | 4 | 2.01 | 2 | 1.00 | 9 | 4.52 | 10 | 5.02 | 3798 | 1243 | 5041 |

NOTA MESATARE (10-12) = 3.31

# VI. SHËNDETËSI DHE MIRËQENIE SOCIALE

Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqënie Sociale, si një nga shtyllat me te rëndësishme të mirqënies qytetare në nivelit lokal, gjatë vitit 2020 edhe përkundër gjendjës së rëndur pandemike ka realizuar me sukses planifikimin vjetor fal bashkëpunimit, punës ekipore dhe koordinimit të mirëfillt të aktiviteteve.

Bazuar në objektivat e drejtorisë janë ofruar shërbime kualitative shëndetësore, ku iniciativa të marra nga komuna dhe donatoret kanë ndikuar në përmirësimin e kushteve në punë për staf shëndetësor dhe administrativë, pajisje të institucionit (QKMF-së) me mjete pune dhe aparaturë si dhe trajnimi i personelit për shërbime sa më kualitative.

Duke e ditur rëndësin e Mjekësisë Familjare e cila paraqet bazën e sistemit shëndetësor, pasiqë parashihet që 80-90% të rasteve të trajtohen në kujdesin parësor shëndetësor, stafi i mjeksisë familjarë kanë ofruar shërbime shëndetësore jo vetëm për banoret e Komunës së Junikut, por edhe për banorët e regjionit perreth që i takojnë me rajonizim.

## 6.1 Shërbimi i Shëndetit Parësor

Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare (QKMF) i ka ofruar të gjitha shërbimet e Shëndetit Parësor me orar ditor pune nga ora: 7:00 deri ne ora: 21,00, ndërkaq në mungesë të stafit është i pa mundshëm organizimi 24 orësh i punës.

QKMF për këtë vitë / 2020, ka realizuar - 32,152 shërbime/ vizita mjekësore, vizata stomatologjike, intervenime, analiza laboratorike, vaksinime, dhe shërbimi i barnatores, shërbime të cila janë realizuara në bazë të strukturës organizative si ne vijim:

- Sektori i Shëndetit Publik,
- Sektori i Mjekësisë Familjare,
- Njësia e SISH-it,
- Njësia e Imunizimit dheVaksinimit,
- Njësia e Stomatologjisë,
- Laboratori
- Barnatorja Qendrore ( Barnatorja është njësi organizative e QKMF-së.

### Furnizimi me barna nga lista esenciale

Autoritetet e Kosovës për Regullativën e Barërave (AKRB) ka aprovuar listën e barnave esenciale, të nevojshme për të plotësuar nevojat shëndetësore të popullatës se Kosovës, për shpërndarjen e barnave është kujdesur Korporata Farmaceutike e Kosovës (KFK), varësisht prej nevojave të Kujdesit Primar Shëndetësor. Produktet farmaceutike nga lista esenciale për vitin 2020 janë planifikuar në bazë të numrit të pacientëve të regjistruar në QKMF, kurse sa i përket furnizimit të QKMF me barna nga Korporata Farmaceutike e Kosovës/Ministria e Shëndetësisë për periudhën vjetore për vitin 2020 ka qenë jo i kënaqshëm për shkak të vështirësive që janë paraqitur nga departamenti farmaceutik pranë Ministrisë së Shëndetësisë dhe përkundër porosive qe janë bërë në mënyrë të rregullt.

Pacient që marrin shërbime të rregullta mujore janë (42 *të sëmurë nga diabeti, qe marrin insulin*)

Vazhdimisht këtë vit shërbimi primar ka qenë i mbuluar me produktet e nevojshme të listës esenciale, furnizimi me Insulinë për pacientët e Komunës sonë ka qenë i kënaqshëm deri në muajt e fundit kü janë vërejtur vështirësi në furnizim nga departamenti farmaceutik i Ministrisë së Shëndetësisë, ku ka rezultuar me vonesa në furnizim.

## 6.2 Shërbimi i shëndetit publik

Shërbimi i shëndetit publik sipas marrëveshjes për mbikqyrjen e ujërave Instituti Kombëtar për Shëndetësi Publike raporton sipas nevojës për gjendjën e ujerave sanitare bakteriologjike kimike të ujit të pijes në Komunën e Junikut, raportimi është bërë në mënyrë të rregullt dhe me kohë.

### Vaksinimi

Vaksinimi në komunën e Junikut kryhet në mënyrë kontinuele dhe në formë kampanje mobile. Numri i shërbimeve për vitin 2020 është 548, vaksinimi dhe plani për sensibilizim për vaksinim është kryer me sukses.

Programi i Zgjeruar i Imunizimeve bëhet bazuar në Planin Strategjik të përgatitur nga Komiteti Nacional i Imunizimeve për Kosovën, ndërsa Plani i imunizimit është punuar në bazë të

dokumentacionit ekzistues (kartotekës) dhe vete lajmërimi për vaksinoni, furnizimi me vaksina nga Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik në Prishtinë është realizuar në baza mujore dhe në përputhje me masat mbrojtëse anti COVID-19, ku fal angazhimit dhe përpikshmërisë është arritur suksesi i duhur.

Gjatë vitit 2020 të gjitha aktivitetet shëndetësore janë fokusuar në menaxhimit e pandemisë Covid-19.

Konform udhëzimeve te Ministrisë së shëndetësisë, IKSHPK-së dhe ligjit për pandeminë Covid19, janë adaptuar hapësirat e nevojshme në objektin e QKMF-së për menaxhimin e pacientëve me Covid, komuna e Junikut fal menaxhimit të mirë të gjendjes dhe diciplines qytetare gjysmën e parë të vitit nuk ka pasur raste të konfirmuara Covid- pozitiv, rastet e para Covid-pozitiv janë paraqitur në muajin korrik 2020, kurse nga korrik-dhjetor 2020 Juniku ka pasur rreth 60 raste të konfirmuara Covid -19 pozitiv nga IKSHPK dhe 4 raste të vdekjes të konfirmuara zyrtarisht si pasojë e virusit Covid-19.

Gjatë kësaj periudhe kohore tërë stafi mjekësor ka qenë i mobilizuar në ofrim të shërbimeve shëndetësore të të gjithë pacientëve pa dallim, ku me konfirmimin e rastit të pare në Kosovë është mobilizuar shtabi Emergjent komunal dhe së bashku me policinë e Kosoves – stacioni ne Junik, inspektoriatin Komunal dhe punëtorët shëndetësor është angazhuar në gjurmimin, izolimin dhe kufizimin e lëvizjes së personave të infektuar dhe personave te kontaktit.

Numri më i madh i rasteve te infektuara me COVID-19 ka qenë gjatë muajve nëtor-dhjetor, ku kapacitet tona shëndetësore janë ngarkuar, kjo edhe pasiqë përpos pacientëve të infektuar me t Covid-19 nga Komuna e Junikut ndihmë dhe trajtim mjekësor iu është ofruar edhe pacientëve të infektuar nga komunat tjera.

Furnizimi me material mbrojtës per stafin mjekësor është bërë vazhdimisht nga Ministria e Shëndetësisë në sasi të mjaftueshme.

Gjatë gjithë kësaj periudhe ju është ofruar ndihmë dhe shërbim mjekësor të gjithë pacientëve edhe pse furnizimi me barna nga lista esenciale është bërë vazhdimisht, por në sasi jo të mjaftueshme për t'i mbuluar kërkesat dhe nevojat e pacientëve e sidomos të pacientëve me Covid.

Numri i shërbimeve shëndetësore të ofruara gjatë kësaj periudhe kohore është paraqitur në tabelat e mëposhtme ku shuma totale e shërbimeve të kryera është: 32,162.

Shërbimet e kryera nga QKMF-ja, sipas muajve.

| Sherbimet e kryera sipas muajve | | Nr. i Sherbimeve | Departamenti |
|---|---|---|---|
| 01 | Janar | 3,390 | QKMF |
| 02 | Shkurt | 3,214 | QKMF |
| 03 | Mars | 3,111 | QKMF |
| 04 | Prill | 1,584 | QKMF |
| 05 | Maj | 2,238 | QKMF |
| 06 | Qershor | 2,654 | QKMF |
| 07 | Korrik | 2,016 | QKMF |
| 08 | Gusht | 2,288 | QKMF |
| 09 | Shtator | 2,237 | QKMF |
| 10 | Tetor | 2,577 | QKMF |
| 11 | Nëntor | 3,480 | QKMF |
| 12 | Dhjetor | 3,373 | QKMF |
| | Gjithsejt | 32,162 | |

**Raporti i gjenerimit të hyrave nga shëndetësia në bazë të participimit të qytetarëve Janar – Qershor/ 2020.**

Zyrtari përgjegjës i shërbimit ekonomiko-financiar është kujdesur për zbatimin e dispozitave ligjore ekonomiko-financiare dhe ka qenë përgjegjës për afarizmin e Drejtorisë të Shëndetësisë.

| Muaji: | Shuma: | Viti | Departamenti |
|---|---|---|---|
| Janar | 391.00 € | 2020 | QKMF |
| Shkurt | 372.00 € | 2020 | QKMF |
| Mars | 466.00 € | 2020 | QKMF |
| Prill | 223.00 € | 2020 | QKMF |

| | | | |
|---|---|---|---|
| Qershor | 117.50 € | 2020 | QKMF |
| Korrik | 125.00 € | 2020 | QKMF |
| Gusht | 63.00 € | 2020 | QKMF |
| Shtator | 246.00 € | 2020 | QKMF |
| Tetor | 305.00 € | 2020 | QKMF |
| Nëntor | 395.00 € | 2020 | QKMF |
| Dhjetor | 526.50 € | 2020 | QKMF |
| Gjithsejt | 3,295.50 € | 2020 | QKMF |

Gjenerimi i të hyrave nga shëndetësia në bazë të participimit të qytetarëve në periudhën Janar-Dhjetor 2020 kanë arritur të inkasohën 3,295.50 € .

## 6.3 Shërbimet Sociale dhe Shërbimi i Kujdestarisë

Shërbimi Social dhe shërbimi i Kujdestarisë i ka zhvilluar këto Aktivitete.

- *Delikuencë e të miturve,*
- *Besimi i fëmijëve,*
- *Procedura të Pajtimit për çiftet bashkëshortore me probleme në bashkëshortësi,*
- *Shkurorëzime,*
- *Kontaktim prind- fëmijë,*
- *Fëmijë me aftësi të kufizuar- kërkesa për ndihme Sociale,*
- *Caktim i kujdestarisë,*
- *Dhunë familjare,*
- *Martesa para moshës madhore.,*
- *Bashkim familjar,*
- *Fëmijë nën kujdestari,*
- *Strehim familjar,*
- *Strehim familjar tek te afërmit,*
- *Strehim në institut special ISSH (për persona me aftësi të kufizuar),*
- *Vërtetim për humbjen e shtetësisë së RKS-s,*
- *Vërtetim për përfitimin e shtetësisë së RKS-s,*
- *Vërtetim që nuk i është hequr zotësia e veprimit,*
- *Këshilla për persona ne nevojë.*

Numri i rasteve i këtyre shërbimeve është i paraqitur më poshtë në mënyrë tabelare:

| Nr. | Përshkrimi i Punëve (Shërbimeve) të kryera | Nr. i lëndëve (Rasteve) | Ver |
|---|---|---|---|
| 1 | Anamnezë për persona me aftësi të kufizuar | 0 | 0 |
| 2 | Anamnezë për persona të mitur delikuent | 1 | 0 |
| 3 | Delikuencë e të miturve | 1 | 0 |
| 4 | Mendim për Gjykatë për Besim të fëmijëve të çifteve në ndarje (shkurorëzim) | 1 | 0 |
| 5 | Kërkesa nga Gjykatat për Procedurë të Pajtimit në mes të çiftëve në ndarje (shkurorëzim) | 0 | 0 |
| 6 | Ftesa për Procedurë të Pajtimit në mes të çiftëve në ndarje (shkurorëzim) | 0 | 0 |
| 7 | Procedurë të Pajtimit në mes të çiftëve në ndarje (shkurorëzim) | 0 | 0 |
| 8 | Raport për Gjykatë për Procedurë të Pajtimit në mes të çiftëve në ndarje (shkurorëzim) | 0 | 0 |
| 9 | Raport për Gjykatë për Adoptim | 1 | 0 |
| 10 | Pajtim i arritur në mes të çiftëve në ndarje-shkurorëzim | 0 | 0 |
| 11 | Kërkesa të pranuara për Kontaktim me fëmijë-prind | 0 | 0 |
| 12 | Kërkesa për kontaktim me fëmijë-prind nga QPS drejtuar Gjykatës dhe QPS-ve tjera | 0 | 0 |
| 11 | Kontaktim me fëmijë-prind | 0 | 0 |
| 12 | Kërkesa për përkrahje financiare për familjet me Fëmijë me aftësi të kufizuar të përhershme | 0 | 0 |
| 13 | Komision Mjekësor për Fëmijë me aftësi të kufizuar të përhershme | 0 | 0 |
| 14 | Familje që marrin përkrahje financiare për fëmijë me aftësi të kufizuar të përhershme | 4 | 0 |
| 15 | Konstatim i gjendjes Sociale- familjare | 1 | 0 |
| 16 | Heqja e Zotësisë së Veprimit | 1 | 0 |
| 17 | Kërkesa për Vërtetim që nuk është hequr Zotësia e Veprimit (*për leje të punës dhe armëmbajtjes)* | 18 | 0 |
| 18 | Vërtetim qe nuk i është hequr zotësia e veprimit (*për leje të punës dhe armëmbajtjes)* | 18 | 0 |
| 19 | Shkresa për DMS-Prishtinë | 2 | 0 |
| 20 | Caktim i kujdestarisë së përkohshme për: Nxjerrje të Dokumenteve; - Udhëtime jashtë vendit. | 0 | 0 |
| 21 | Dhunë familjare | 2 | 0 |
| 22 | Martesa para moshës madhore | 0 | 0 |
| 23 | Bashkim familjar | 0 | 0 |

| | | | |
|---|---|---|---|
| 24 | Fëmijë nën kujdestari | 1 | 0 |
| 25 | Kërkesa për vendosje në institut special<br>*(për persona me aftësi të kufizuar)* | 0 | 0 |
| 26 | Strehim në institut special ISSH<br>*(për persona me aftësi të kufizuar)* | 0 | 0 |
| 27 | Kërkesë për vazhdim të strehimit në ISSH<br>*(për persona me aftesi të kufizuar)* | 0 | 0 |
| 28 | Strehim familjar tek te afërmit | 1 | 0 |
| 29 | Deklarata për Çështje të ndryshme Sociale | 22 | 0 |
| 30 | Aktvendim për Kujdestari | 0 | 0 |
| 31 | Vertetim për Kujdestari | 1 | 0 |
| 32 | Kërkesa për Vërtetim që nuk ka Kujdestari<br>*(për lirim nga statusi Shtetas i Republikës së Kosovës)* | 29 | 0 |
| 33 | Pëlqim Prindëror për të mitur<br>*(për lirim nga statusi Shtetas i Republikës së Kosovës)* | 0 | 0 |
| 34 | Vërtetim që nuk ka Kujdestari<br>*(për lirim nga statusi Shtetas i Republikës së Kosovës)* | 29 | 0 |
| 35 | Kërkesa për Vërtetim që nuk ka Kujdestari<br>*(Për përfitimin e statusit Shtetas/e i/e Republikës së Kosovës)* | 1 | 0 |
| 36 | Vërtetim që nuk ka Kujdestari<br>*(Për përfitimin e statusit Shtetas/e i/e Republikës së Kosovës)* | 1 | 0 |
| 37 | Asistime në Polici për raste sociale-familjare | 3 | 0 |
| 38 | Asistime në Gjykatë për raste sociale familjare | 4 | 0 |
| 39 | Klient të tjerë<br>*( për konsultime dhe këshillime)* | 12 | 0 |
| | Totali | 138 | 0 |

## 6.4 Shërbimi i Skemës së ndihmës sociale

Shërbimi i skemës së ndihmës sociale ka zhvilluar, këto aktivitete sipas detyrave të punës:

- Menaxhimin e Skemës së ndihmës sociale,
- Pranimin dhe shqyrtimin e kërkesave të reja për ndihmë sociale,
- Verifikimin në terren të kërkesave të reja për ndihmë sociale,
- Pranimi i ri aplikimeve për ndihmë sociale dhe shqyrtimin e tyre,

- Verifikimi dhe riverifikimi në terren i kërkesave të reja dhe riaplikimeve për ndihmë sociale,
- Pranimi i Raporteve mjekësore, procedimi i tyre dhe dërgimi i tyre në Komision mjekësor për ekzaminim,
- Pranimi dhe shqyrtimi i Ankesave dhe dërgimi i tyre në shkallë më të larta të ankesës,
- Operimi me Bazën e të dhënave të SNS-s,
- Raportimi.

Ky sektor gjatë këti viti pandemik ka qenë i angazhuar edhe me detyra shtesë si: Pranimin dhe shpërndarjen e ndihmave humanitare derë më derë (si masë mbrojtëse anti COVID) dhe pranimin, procedimin dhe futjen e të dhënave në bazë të Aplikacioneve për pakon emergjente M 15. Gjatë këtij viti ka qenë angazhimi maksimal, ku ndihmat dhe shërbimet janë ofruar në kohë dhe me mirësjellje.

Puna dhe aktivitetet e SNS (Skemës së Ndihmës Sociale) të paraqitura në form tabelare të kryera duke u bazuar në Ligjin për Skemën e Ndihmës Sociale 2003 /15 dhe në Ligjin për ndryshimin e ligjit të SNS 2003/15, Ligjin 04/L- 096.

**Familjet përfituese të ndihmës sociale për vitin 2020**

| Muaji | Nr. i Familjeve shfrytëzuese të NS | Nr. i ant. Të familjeve | Shuma në Euro |
|---|---|---|---|
| Janar | 59 | 182 | 5482.00 € |
| Shkurt | 57 | 179 | 5462.00 € |
| Mars | 57 | 179 | 10713.00 € |
| Prill | 58 | 184 | 11060.00 € |
| Maj | 58 | 182 | 10780.00 € |
| Qershor | 57 | 177 | 5280.00 € |
| Korrik | 55 | 174 | 5137.50 € |
| Gusht | 58 | 184 | 5780.00 € |
| Shtator | 57 | 183 | 5395.00 € |
| Tetor | 59 | 189 | 11262.50 € |
| Nëntor | 57 | 183 | 10725.00 € |
| Dhjetor | 59 | 191 | 11240.00 € |
| **Totali** | 691 : 12 = 57.58 | 2187 : 12 = 182.2 | 98,317.00 € |
| SHUMA TOTALE E PAGESES VJETORE | | 98,317.00 € | |

Familjet që kanë ri-aplikuar për ndihmës sociale dhe iu është aprovuar NS, për vitin 2020

| Muaji | Nr. i familjeve që kanë riaplikuar | Nr. i ant. të familjeve | Kategoria e parë | Kategoria e dytë | Riaplik-ime të Aprovua-ra | Riaplik-ime të Refuzu-ara | Totali Mujor |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Janar | 10 | 28 | 8 | 2 | 10 | 0 | 10 |
| Shkurt | 5 | 17 | 4 | 1 | 5 | 0 | 5 |
| Mars | 12 | 41 | 9 | 3 | 12 | 0 | 12 |
| Prill | 10 | 30 | 5 | 5 | 10 | 0 | 10 |
| Maj | 5 | 10 | 2 | 3 | 5 | 0 | 5 |
| Qershor | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Korrik | 5 | 23 | 1 | 4 | 5 | 0 | 5 |
| Gusht | 4 | 16 | 3 | 1 | 4 | 0 | 4 |
| Shtator | 5 | 15 | 2 | 3 | 5 | 0 | 5 |
| Tetor | 5 | 21 | 0 | 5 | 5 | 0 | 5 |
| Nëntor | 5 | 16 | 4 | 1 | 5 | 0 | 5 |
| Dhjetor | 4 | 10 | 4 | 0 | 4 | 0 | 4 |
| Totali Vjetor | 70 | 235 | [illegible] | 28 | 70 | 0 | 70 |

Gjatë vitit 2020 kemi pranuar ndihma humanitare dhe kemi berë pranimin dhe shpërndarjen e ndihmave humanitare, sipas urdhëzimeve të Shtabit të Emergjencës në Komunën e Junikut, ndihmat kanë ardhur nga organizata dhe shoqata të ndryshme, të cilat kanë ofruar pako ushqimore e higjenike për familje në nevojë si masë mbështetëse në kohë pandemie.

Më poshtë poshtë ju paraqesim të dhënat e donatoréve dhe përfituesve të këtyre ndihmave;

| Nr | Donatori | Artikulli | Sasia | Data | Pranuesi |
|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Kryqi i Kuq i Kosovës | Pako Ushqimore | 50 | 20.03.2020 | QPS - Junik |
| 2 | Kryqi i Kuq i Kosovës | Pako Higjienike | 200 | 28.03.2020 | QPS - Junik |
| 3 | OJQ Jetimat e Ballkanit | | 100 | 09.04.2020 | QPS - Junik |
| 4 | Viva Fresh dhe Buqaj Company | | 50 | | |
| 5 | Kryqi i Kuq i Kosovës | Pako Higjienike | | 02.05.2020 | QPS - Junik |
| 6 | UNMIK-u | Pako Ushqimore<br>Pako Higjienike | 50<br>30 | 15.05.2020 | Kryetari i Komunës |
| 7 | Lobi Euroatlantik dega në Zvicër | | 13 | | QPS - Junik |

Gjatë Periudhës Prill - Qershor 2020 , sipas Vendimit me nr. 35/2020 të datës: 16.04.2020 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, përkatësisht Ministrisë së Financave dhe Transfereve kemi pranuar aplikacione për familje që nuk kanë asnjë të punësuar dhe që nuk kanë të hyra financiare për: Pakon Emergjente sipas Masës nr. 15, në QPS-n e Junikut, Shërbimi i SNS-s që nga data: 20.04.2020, kemi bërë pranimin, procedimin dhe futjen në bazë të të dhënave të aplikacioneve të Paketës Emergjente M-15

Numri i aplikimeve në muajin Prill 2020 për Pakon Emergjente Masa nr.15

| Data | Aplikime Fizike | Aplikime Online | Numri total i Aplikimeve |
|---|---|---|---|
| 21.04.2020 | 2 | 0 | 2 |
| 22.04.2020 | 7 | 0 | 7 |
| 23.04.2020 | 4 | 1 | 5 |
| 24.04.2020 | 6 | 0 | 6 |
| 27.04.2020 | 7 | 2 | 9 |
| 28.04.2020 | 10 | 0 | 10 |
| 29.04.2020 | 3 | 1 | 4 |
| 30.04.2020 | 5 | [illegible] | 3 |
| Totali | 44 | 4 | 48 |

Numri i aplikimeve në muajin Maj 2020 për Pakon Emergjente Masa nr.15

| Data | Aplikime Fizike | Aplikime Online | Numri total i Aplikimeve |
|---|---|---|---|
| 04.05.2020 | 4 | 3 | 7 |
| 05.05.2020 | 3 | 2 | 5 |
| 06.05.2020 | 2 | 0 | 2 |
| 07.05.2020 | 2 | 1 | 3 |
| 08.05.2020 | 2 | 0 | 2 |
| 12.05.2020 | 4 | 3 | 7 |
| 13.05.2020 | 1 | 0 | 1 |
| Totali | 18 | 9 | 27 |

Familjet përfituese të ndihmës nga pakoja emergjente M15

| Nr. | Muaji dhe Viti | Numri i familjeve përfituese | Shuma në euro për familje | Shuma e totale e përfituar për muaj |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Prill - 2020 | 23+3=26 | 130.00 € | 3380.00 € |
| 2 | Maj - 2020 | 23+3=26 | 130.00 € | 3380.00 € |
| 3 | Qershor - 2020 | 22+3=25 | 130.00 € | 3250.00 € |
| Shuma e totale e përfituar për 3 muaj | | | | 10010.00 € |

Familjet që ju është refuzuar ndihma nga pakoja emergjente M15

| Nr. | Muaji dhe Viti | Numri i familjeve të refuzuara |
|---|---|---|
| 1 | Prill - 2020 | 52 |
| 2 | Maj - 2020 | 52 |
| 3 | Qershor - 2020 | 53 |

Familjet që kanë ushtruar ankesë kundrejt refuzimit të ndihmës nga pakoja emergjente M15

| Nr. | Muaji | Ankesa të parashtruara | Ankesa të shqyrtuara | | Totali Mujor |
|---|---|---|---|---|---|
| | | | Ankesa të Aprovuara | Ankesa të Refuzuara | |
| 1 | Prill - 2020 | 3 | 3 | 0 | 3 |
| 2 | Maj - 2020 | 3 | 3 | 0 | 3 |
| 3 | Qershor - 2020 | 3 | 3 | 0 | 3 |
| Totali tremujor | | 9 | 9 | 0 | 9 |

Familjet përfituese të Skemës së ndihmës sociale përpos ndihmës në para të gatshme, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS) këto familje i ndihmon duke ia mbuluar shpenzimet e Energjin Elektrike deri në 20 Euro për muaj.

Familjet përfituese me të gjithë anëtarët e tyre përfitojnë Shërbime Mjekësore falas në të gjitha Qendrat Mjekësore Publike.

Të gjithë anëtarët e këtyre familjeve janë përfitues të shërbimeve administrative falas në gjithë administratën publike (Shtetërore) të Republikës së Kosovës.

Të gjithë anëtarët e këtyre familjeve që vijojnë studime universitare dhe pas universitare në Universitetet publike të Republikës së Kosovës janë të liruar nga të gjitha pagesat.

## VII. SHËRBIMEVE PUBLIKE, ISNPEKSION, MBROJTJE DHE SHPËTIM

Drejtoria për Shërbime Publike Inspekcion Mbrojtje dhe Shpëtim aktivitetin vjetor bazuar në detyrat e punës dhe planifikimin vjetor gjatë vitit 2020 e ka realizuar me sukses pa marr parasysh situaten pandemike.

Aktivitetet e Drejtorsë janë fokusuar në rregullimin e qytetit dhe mbrojtjen e ambientit, mirëmbajtjen verore dhe dimërore të rrugëve lokale të asfaltuara dhe të rendit të katërt, rregullimin e qarkullimit të komunikacionit, sinjalizimin horizontal dhe vertikal, parkingjet, transportin lokal, përcjelljen e procedurës së pastrimit të ujërave atmosferike nga sipërfaqet publike, mbikëqyrjen e punës së lëmisë së furnizimit me ujë dhe largimin e ujërave të zeza, menaxhimin e procedurave të hartjes dhe deponimit të hedhurinave, pastrimin dhe larjen e rrugëve, shesheve dhe sipërfaqeve publike, mirëmbajtjen e shtratit të lumit Erenik, mirëmbajtjen e ndriçimit publik, mirëmbajtjen e varrezave, në [illegible] dhe menaxhimin e punës së autoparkut të Komunës.

Në kuadër të kesaj drejtorie aktivitete janë realizuar permes sektoreve si ne vijim:

- **Sektori për Shërbime Publike dhe Inspeksion,**
- **Sektori për Mbrojtje dhe Shpëtim.**

## 7.1 Sektori për Shërbime Publike dhe Inspeksion,

| Personi I Autorizuar / Nr. I Aktivitetit | Proqes | Aktvend | Bashkëpunin më PK-në | Vërtetim | Pëlqime Leje nder. | Kërkesa nga e personave Juridik dhe | Kërkesa për Gjykatën Komunale pë Kundërvatje | Kërkesa të shqyruara nga Gjykata për Kundërvatje | Procedura shqyrtim | Nderp. punimes | Treg të gjelb. Kontrol la për pastrim | Plot Kus Hixh.Tek |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Insp. I tregut,bujqësi,amble | 46 | 4 | 14 | 5 | 10 | 19 | 0 | 0 | 2 | | 42 | 8 |
| Inspektori I Ndërtimit | 30 | 3 | 40 | / | 4 | 6 | | | 0 | 3 | / | / |
| Insp. I Trafikut, Sanitar & Turizem | 94 | 0 | 48 | 7 | 10 | 10 | 0 | / | 0 | | / | 8 |
| Totali/Puna e përgjithshme | 170 | 7 | 102 | 12 | 24 | 35 | 0 | 0 | 2 | 3 | 42 | 16 |

## 7.2 Sektori për mbrojtje dhe shpëtim

Sektori për mbrojtje dhe shpëtim për përmbushjen dhe realizimin e aktiviteteve gjatë vitit 2020 është bazuar në:

- Ligjin për Mbrojtje nga FN dhe FT, Ligjin për Mbrojtje nga Zjarri, Ligji për Mbrojtje dhe Shpëtim, si dhe udhëzimeve administrative të aprovunra nga Kuvendi i Kosovës;
- Planet vjetore për mbrojtje dhe shpëtim, me qëllim të jetësimit të këtyre ligjeve për mbrojtje të jetës së njerëzve, kafshëve dhe të mirave materiale;
- Urdhëresat dhe rekomandimet të dalu nga takimet e këshillit të drejtorëve dhe vendimet e Drejtorit të Drejtorisë për SHPIM dhe SH;
- Kërkesat e drejtuara për Drejtorinë për SHPIM dhe SH, përkatësisht sektorit për Mbrojtje dhe Shpëtim;
- Shërbimi për Zjarrfikës dhe Shpëtim si shërbimi emergjent për operime-reagime të shpejta.

Të dhënat e aktiviteteve të Njësisë së **Zjarrfikësve në Komunën e Junikut gjatë vitit 2020:**

- *Gjatë stinës së Dimrit Njesia e Zjarrfikësve ka bërë pastrimin e rrugëve të qytezës me kamion të Zjarrfikësve non-stop 24 orë,*
- *Vetëdiesimi i qytetarëve përmes fletëpalosjeve për ruajtjen e pyjeve nga zjarret,*
- *Mbushja e Aparateve kundër Zjarrit në të gjitha Institucioinet,*
- *Janë hapur rrugët malore për të pasur qasje kamioni i Zjarrfikësve,*
- *Mbajtja e ligjëratave teorike dhe ushtrime praktike në stacionin e zjarrfikësve,*
- *Kemi kryer etyra sipas nevojës siç ishin: vendosja e flamujve për festa, vendosja e panove te ndryshme etj*

Realizimi i numrit të përgjithshëm të daljeve,struktura e daljeve dhe intervenimeve tjera për periudhen kohore Janar- Dhjetor 2020

| KATEGORIZIMI I ZJARREVE DHE INTERVENIMEVE SIPAS MUAJVE GJATË VITIT 2014 | | | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | LLOJI I INTERVENIMIT | Jan. | Shku. | Mars | Prill | Maj | Qer. | Korr. | Gush. | Shta. | Tet. | Nënt. | Dhje. | GJITHESEJTË |
| 1 | ZJARRE | | | | | | | | | | | | | |
| 2 | INTERVENIME TEKNIKE | | | | | | | | | | | | | |
| 3 | SHËRBIME | 2 | 4 | 1 | 1 | 3 | | 1 | | 1 | 1 | 2 | 2 | |
| 4 | AKSIDENTE KOMUNIKACIONI | | | | | | | | | | | | | |
| 5 | VËRSHIME | | | | | | | | | | | | | |
| 6 | ALARME TË RREJSHME | | | | | | | | | | | | | |
| | Gjithësejtë: | | | | | | | | | | | | | |
| 1. | Ndarja analitike e zjarreve në | OBJEKTE NDËRTIMORE | | | | | | | | | | | | |
| 1.1 | Banesa – shtëpi | | | | 1 | | | | | 1 | | | 1 | |
| 1.2 | Objekte ndimëse | | | | | | | | | | 1 | | | |
| 1.3 | Plevica - shtalla | | | | | | | | | | | | | |
| 1.4 | Objekte kolektive (banesa) | | | | | | | | | | | | | |
| 1.5 | Oxhaqe | | | | 2 | | | | | | | | | |
| 1.6 | Të tjera | 2 | | | | | | | | | | | | |
| | Gjithësejtë: | | | | | | | | | | | | | |
| 2. | Ndarja analitike e zjarreve në | OBJEKTE EKONOMIKE | | | | | | | | | | | | |
| 2.1 | Publike | | | | | | | | | | | | | |
| 2.2 | Objekte Biznesi | | | | | | | | | | | | | |

| | | | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 2.3 | Objekte indusiale | | | | | | | | | | | | | |
| 2.4 | Të tjera | | | | | | | | | | | | | |
| | Gjithësejtë: | | | | | | | | | | | | | |
| 3. | Ndarja analitike e zjarrëve në: PAISJE ELEKTRIKE | | | | | | | | | | | | | |
| 3.1 | Paisjet elektrike / trafo | | | | | | | | 1 | | | | | |
| 3.2 | Paisjet shpërndarëse | | | | | | | | | | | | | |
| 3.3 | Gjenerator | | | | | | | | | | | | | |
| 3.4 | Të tjera | 1 1 | | | | 1 | | | | | | 1 | | |
| | Gjithësejtë: | | | | | | | | | | | | | |
| 4. | Ndarja analitike e zjarrëve në: SIPËRFAQE TË HAPURA | | | | | | | | | | | | | |
| 4.1 | Mal | | 5 ha | 3ha | 7 | | | 2-ha | 8-ha | 5-ha | | | | |
| 4.2 | Sipërfaqja e djegur (hektar) | | | 1 ha | 120 ha [illegible] | | | | | 5 ha mall djegur | | | | |
| 4.3 | Bari i thatë | | | | 1 | | | | | | | | | |
| 4.4 | Sipërfaqja e djegur (hektar) | | | | 1 ha | | | | | | | | | |
| 4.5 | Sipërfaqe bujqsore | | | | 1 | | | | | | | | | |
| 4.6 | Sipërfaqja e djegur (hektar) | | | | 5 ha | | | | | | | | | |
| 4.7 | Të tjera | | | | 1 | | | | | | | | | |
| | Gjithësejtë: | | | | | | | | | | | | | |
| 5. | Ndarja analitike e zjarrëve në: AUTOMJETE TRANSPORTI | | | | | | | | | | | | | |
| 5.1 | Automjete motorrike | | | | | | | | | | | | | |
| | Gjithësejtë: | | | | | | | | | | | | | |

| | | | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 6. | Ndarja analitike: | INTERVENIMEVE TEKNIKE | | | | | | | | | | | | |
| 6.1 | INTERVENIME TEKNIKE | | | | 3 | | 2 | | | | | | | |
| 6.2 | SHËRBIME | | | | | | | | | | | | | |
| 6.3 | AKSIDENTE RRUGORE | | | | | | | | | | | | | |
| 6.4 | VËRSHIME | | | | | | | | | | | | | |
| 7. | Të lënduar: | | | | | | | | | | | | | |
| 7.1 | Zjarrfikës | | | | | | | | | | | | | |
| 7.2 | Qytetarë | | | | | | | | | | | | | |
| | Gjithësejtë: | | | | | | | | | | | | | |
| 8. | Të vdekur: | | | | | | | | | | | | | |
| 8.1 | Zjarrfikës | | | | | | | | | | | | | |
| 8.2 | Qytetarë | | | | | | | | | | | | | |
| | Gjithësejtë: | | | | | | | | | | | | | |
| 9. | Prona: | | | | | | | | | | | | | |
| 9.1 | Shoqërore | x | x | | x | | | | | | | | | |
| 9.2 | Private | | x | | | | | | | | | x | | |
| 10. | Pjesmarrja e zjarrfikësve: | | | | | | | | | | | | | |
| 10.1 | Zjarrfikësa aktiv | 4 | 4 | 4 | 4 | | 4 | | | | | 4 | | |
| 10.2 | Zjarrfikësa vullnetar | 1 | 1 | 1 | 1 | | | | | | | | | |
| 11. | Mjetet e përdorura: | | | | | | | | | | | | | |
| 11.1 | Komanduese | 1 | | | | | | | | | | | | |
| 11.2 | Sulmuese | | 1 | 1 | | | | | | | | 1 | | |

| | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| DSHPSI | 09- DSHPI | 0 | 0 | 497 | 1 | 0 | 0 | 0 | 12 | 0 | 497 |
| | | 0 | 0 | 497 | 1 | 0 | 0 | 0 | 12 | 0 | 497 |

## Të hyrat gjatë vitit 2020

| NR. | Muaj | Pagesa | nr. Pagesave | Lloji i Pag. |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Janar | 100.00 | 1 | kushte higjan-sanit |
| 2 | Shkurt | 200.00 | 3 | kushte higjan-sanit |
| 3 | Mars | 805.00 | 6 | |
| 4 | Prill | // | 0 | |
| 5 | Maj | 45.00 | 1 | |
| 6 | Qershor | 240.00 | 3 | |
| 7 | Korrik | 240.00 | 7 | |
| 8 | Gusht | 180 | 1 | |
| 9 | Shtatori | 80 | 1 | |
| 10 | Tetor | // | | |
| 11 | Nëtor | // | | |
| 12 | Dhejtor | 50 | 1 | |
| | Totali | 1940.00 | | |

| | | | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 11.3 | Tanker | | | | | | | | | | | 1 | | |
| 11.4 | Teknike | | | | | | | | | | | | | |
| 11.5 | Transportuese | | | | | | | | | | | | | |
| 11.6 | Emergjente | | | | | | | | | | | | | |
| 12. | Mjetet [illegible] | | | | | | | | | | | | | |
| 12.1 | Ujë / $m^3$ | | | | | | | | | | | | | |
| 12.2 | Shkumë / lit. | | | | | | | | | | | | | |
| 12.3 | Pluhur / kg. | | | | | | | | | | | | | |
| 12.4 | $CO_2$ / kg | | | | | | | | | | | | | |
| 12.5 | Mjete tjera | | | | | | | | | | | | | |
| 13. | Orë pune | | | | | | | | | | | | | |
| 13.1 | Orë pune | 11 | [illegible] | 14 | 7 | | 3 | 10 | 9 | | | | | |
| 13.2 | Minuta | 40 | 30 | | 50 | | 30 | 30 | 0 | | | 80 | | |
| | GJITHESEJT: | | | | | | | | | | | | | 265 |

Numri i lendeve permes Intranetit gjatë vitit 2020 në Drejtorinë për SHPIM&SH

| Slikurtesa | Pershkrimi | Pranuar | Ne Proces | Miratuar | Refuzuar | Hedhur Poshtë | Pezulluar | Ceduar | Anuluar | Perfunduar | Totali |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | | | | | |

PROJEKTET NË DSHPIM&SH GJATË VITIT 2020

- *Pastrimi i kanalizimit të ujërave të zeza në lagjen Çok,*
- *Rehabilitimi i rrugëve locale,*
- *Mirëmbajtja e hapësirave publike dhe menaxhimi me mbeturina,*
- *Furnizimi dhe sjellja e gypave të plastikës SN 8 fi 800 mm,*
- *Rregullimi i fibrit në QKMF dhe riparimi i kabllove të dëmtuara nga ershat në Junik,*
- *Zhbllokimi i kanalizimit të ujërave të zeza në lagjen Bajraktar*

## VIII. ZYRA E PERSONELIT

Zyra e personelit ka ushtruar aktivitetin e saj me përkushtim maksimal në sigurimin e zbatimit të procedurave ligjore lidhur me menaxhimin dhe zhvillimin e Burimeve Njerëzore në Komunën e Junikut pa marr parasysh veshtiresive të krijuara nga pandemia globale Covid 19.

Të gjitha aktivitetet janë zhvilluar konform dispozitave të përcaktuara sipas Ligjit për Zyrtarët Publik dhe akteve nënligjoret të ndërlidhura me këtë fushë.

Në udhëheqjen e punës së gjithmbarshme të njësisë së burimeve njerëzore, në bashkëpunim me Zyrën e Kryetarit janë identifikuar dhe caktuar objektivat kryesore, dhe në bazë të kësaj është hartuar edhe planit i punës për përmbushjen e këtyre objektivave.

Për të siguruar produkte dhe shërbime cilësore në vlerësimin e proceseve dhe procedurave të brendshme janë rekomanduar ndryshime/përmirësime me qëllim të rritjes së efikasitetit në punë duke siguruar zbatimin e legjislacionit lidhur me menaxhimin dhe zhvillimin e burimeve njerëzore.

Gjithashtu nën përgjegjësinë e sigurimit të mbarëvajtjes së procedurave të rekrutimit të nëpunësve civil, dhe nëpunësve publik, janë përgatitë konkurset, akt emërimet, kontratat për marrëdhënien e punës duke proceduar më tutje pagat si dhe krijimi dhe mirëmbajtja e dosjeve të personelit.

Në vazhdën e aktiviteteve të Zyrës së Personelit gjatë vitit 2020 ka iniciuar procedurën për hartimin e Kodit të Etikes Profesionale e cila njëherit ka qenë edhe bartëse e këtij procesi. Ky dokument i rëndësishëm për institucionin është miratuar sipas procedurave për miratimin e akteve juridike nga Kuvendi Komunal.

Sa i përket raportimi në Agjensionin Antikorrupcion të Kosovës me kërkesë të këtij institucioni janë ofruar deklarime mujore lidhur me ndryshimin e statusit të zyrtarëve të lartë publik dhe respektimit të ligjit për konfliktin e interesit.

Komuna e Junikut për vitin kalendarik 2020, ka të autorizuar 163 pozita pune, ndërsa në evidencën e Zyrës së Personelit në periudhën 01.01.2020 deri 31.12.2020, janë të evidentuar gjithsejtë 170, duke marr parasyshë mesimdhenesit me normë jo të plotë.

Gjatë kësaj periudhe, Zyra e Personelit ka zhvilluar procedurat të brendshme të rekrutimit për Administratën Komunale, dhe procedura të jashtme për QKMF-në.

Konform Rregullores mbi Procedurat e Vlerësimit të rezultateve të punës, Zyra e Personelit ka kryer të gjitha obligimet dhe gjithashtu janë dhënë sqarime të nevojshme lidhur me vlerësimin sipas sistemit SIMBNJ.

Në koordinim më Ministrinë e Administratës Publike, është raportuar lidhur me nevojat për trajnim profesional të stafit komunal dhe njëherit është hartuar Plani për trajnimin e stafit për vitin 2020. Gjithashtu Zyra e personelit ka hartuar edhe akte juridike për Zyrën e Kryetarit.

## 8.1 Shërbimi i Kuvendit

Ky shërbim gjatë kësaj periudhe ka kryer shërbime juridike për Kuvendin Komunal konform ligjeve dhe akteve nënligjore në fuqi. Në periudhën raportuese janë kryer shërbimet si në vijim:

- *Raportimi i rregullt në periudha periodike në MPL,*
- *Mbajtja e të dhënave për anëtarët e Kuvendit Komunal,*
- *Hartimi i vërtetimeve,*
- *Informimi i MAPL-së dhe anëtareve të Kuvendit për aktivitetet e Kuvendit,*
- *Dërgimi i të gjitha akteve të aprovuara nga Kuvendi brenda afatit ligjor për shqyrtim të rregullt të ligjshmërisë në Departamentin ligjor.*

# IX. PROKURIMI PUBLIK

Gjatë periudhës kohore Janar- Dhjetor 2020, Zyra e Prokurimit ka nënshkruar gjithsej 38 (tridhjetë e tetë) kontrata për projekte të ndryshme të cilat i ka zhvilluar përmes procedurave të prokurimit, 22 (njëzetë e dy) prej kontratave të nënshkruara nuk kanë qenë të planifikuara sepse disa prej tyre si aktivitetet për: Dezinfektim të hapësirave publike, Furnizim me maska, Spërkatja e hapësirave publike me dezinfektant etj kanë ardhur si rezultat i gjendjes pandemike COVID- 19, periudhë e cila ka ndikuar dukshëm edhe në mosrealizimin e shumë prej projekteve të cilat i kishim planifikuar t'i realizojmë në vitin 2020.

Prej këtyre projekteve të realizuara gjatë periudhës Janar- Dhjetor 2020, 27 (njëzetë e shtatë) kontrata të nënshkruara janë përfunduar me sukses në vitin 2020, 6 (gjashtë) kontrata të nënshkruara përfundojnë në vitin 2021, 2 ( dy) kontrata të nënshkruara përfundojnë në vitin 2022 dhe 2 (dy) kontrata të nënshkruara përfundojnë në vitin 2023, ndërsa një kontratë edhepse është nënshkruar është anuluar për arsye se OE fitues nuk e ka kryer furnizimin sipas kontratës së nënshkruar ( OE në fjalë për mospërmbushjen e obligimeve kontraktuale gjendet në Listën e Zezë të OSHP-së). Nga numri i kontratave të nënshkruara dhe të realizuara rezulton se të gjitha kërkesat për inicimin e aktiviteteve të prokurimit nga secila Njësi e Kërkesës është realizuar në tërësi dhe me sukses nga Zyra e Prokurimit.

Raporti i kontratave të nënshkruara për periudhën kohore Janar- Dhjetor 2020

| Nr. | Titulli i kontratës së nënshkruar mes Autoritetit Kontraktues dhe Operatorëve Ekonomik | Klasifikimi i kontratës sipas vlerës së nënshkruar | Data e nënshkrimit të kontratës | Data e përfundimit të kontratës | Çmimi i përgjithshëm i kontratës së nënshkruar |
|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Ndërtimi i rrugës Junik- Gjeravicë | Vlerë e Madhe | 21.10.2020 | 21.10.2023 | € 4,416,859.77 |
| 2 | Transporti i nxënësve me autobus në relacionin, lagjja Agim Ramadani - shkollë dhe anasjelltas | Vlerë e Mesme | 12.05.2020 | 12.05.2023 | € 35,760.60 |
| 3 | Spërkatja e hapësirave të objekteve publike me dezinfektues kundër virusit Covid-19 në territorin e Komunës së Junikut | Vlerë e Vogël | 20.03.2020 | 20.04.2020 | € 2,100.00 |
| 4 | Pastrimi i kanalizimit të ujërave të zeza në lagjen Qok | Vlerë Minimale | 06.04.2020 | 09.04.2020 | € 980.00 |
| 5 | Punimi i mbulojës për gjenerator për QKMF- në | Vlerë Minimale | 21.04.2020 | 01.05.2020 | € 295.00 |
| 6 | Hapja e rrugëve fushore- Faza e III- të | Vlerë e Mesme | 08.06.2020 | 30.06.2021 | € 33,793.75 |
| 7 | Asfaltimi i rrugëve lokale | Vlerë e Mesme | 23.07.2020 | 30.08.2022 | € 79,920.70 |
| 8 | Blerja e automjetit për nevojat e Komunës | Vlerë e Mesme | 22.06.2020 | 22.06.2021 | € 29,999.75 |
| 9 | Asfaltimi i rrugës Junik- Gjocaj | Vlerë e Mesme | 13.07.2020 | 31.12.2020 | € 201,635.00 |
| 10 | Furnizim me dru për shkollat e Komunës së Junikut | Vlerë e Vogël | 06.07.2020 | 06.09.2020 | € 6,900.30 |
| 11 | Rehabilitimi i rrugëve lokale | Vlerë e Mesme | 07.08.2020 | 07.08.2022 | € 49,990.00 |
| 12 | Furnizim me gjenerator për Komunën e Junikut<br>KONTRATE E DESHTUAR PERMOSFURNIZIM TE GJENERATORIT | Vlerë e Vogël | 28.10.2020 | 28.12.2020 | € 9,500.00 |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 13 | Vendosja e roletave në objektin e Komunës | Vlerë e Vogël | 30.07.2020 | 03.10.2020 | € 2,823.82 |
| 14 | Ndërtimi i shtëpizës bjeshkatare- alpine- Faza e II- të | Vlerë e Mesme | 03.09.2020 | 03.09.2021 | € 70,783.02 |
| 15 | Mirëmbajtja e hapësirave publike dhe menaxhimi me mbeturina | Vlerë e Vogël | 17.08.2020 | 17.03.2021 | € 8,496.00 |
| 16 | Dezinfektimi i QKMF- së dhe Administratës Komunale | Vlerë Minimale | 28.07.2020 | 28.08.2020 | € 627.00 |
| 17 | Furnizim me klima për objektin e QKMF- së, Dr. Ali Hoxha | Vlerë e Vogël | 14.10.2020 | 14.11.2020 | € 2,130.00 |
| 18 | Furnizime mjekësore për QKMF- në, Dr. Ali Hoxha | Vlerë e Vogël | 23.09.2020 | 23.09.2021 | € 9,729.90 |
| 19 | Furnizim me material administrativ për shkolla | Vlerë Minimale | 08.09.2020 | 18.09.2020 | € 770.20 |
| 20 | Furnizimi i tubave të materialit Allkaten për ujësjellësin e fshatit Gjocaj | Vlerë Minimale | 09.09.2020 | 19.09.2020 | € 980.60 |
| 21 | Furnizim me maska për nxënës | Vlerë Minimale | 09.09.2020 | 19.09.2020 | € 999.00 |
| 22 | Furnizim me termometër non contact infrared për shkolla | Vlerë Minimale | 30.09.2020 | 12.10.2020 | € 270.00 |
| 23 | Punimi i lëshesës gypore në Jasiq dhe renovimi i murit mbrojtës të kanalit të ujitjes | Vlerë Minimale | 17.09.2020 | 27.09.2020 | € 950.00 |
| 24 | Për LOT I Furnizim me paisje dhe material shpenzues për mirëmbajtje Për LOT II Furnizim me material higjienik | Vlerë e Vogël | 25.11.2020 | 25.04.2021 | Për LOT I € 2,079.90<br>Për LOT II € 3,723.30 |
| 25 | Marrja në shfrytëzim e paisjeve për spërkatjen e duarve me dezinfektant | Vlerë e Vogël | 11.11.2020 | 11.11.2021 | € 3,240.00 |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 26 | Transporti i nxënësve Junik ( shkollë e mesme)-Ponoshec dhe anasjelltas | Vlerë e Mesme | 06.11.2020 | 06.11.2021 | € 11,040.00 |
| 27 | Renovimi i banjove në shkollat e Komunës së Junikut | Vlerë Minimale | 08.10.2020 | 18.10.2020 | € 989.90 |
| 28 | Mirëmbajtja e kamerave | Vlerë Minimale | 29.10.2020 | 09.11.2020 | € 650.00 |
| 29 | Furnizimi dhe sjellja e gypave të plastikës SN 8 Ø 800 mm | Vlerë Minimale | 26.11.2020 | 07.12.2020 | € 950.40 |
| 30 | Rregullimi i fibrit në QKMF dhe riparimi i kabllove të dëmtuara nga erërat në Junik | Vlerë Minimale | 01.12.2020 | 11.12.2020 | € 988.25 |
| 31 | Renovimi i pllakës së Dëshmorëve | Vlerë Minimale | 28.10.2020 | 02.11.2020 | € 931.60 |
| 32 | Rregullimi i instalimit të ujit në arsimin fillor | Vlerë Minimale | 03.12.2020 | 13.12.2020 | € 989.20 |
| 33 | Furnizim me material administrativ ( notesa B5, kalendar tavoline dhe lapsa kimik me mbishkrim dhe logo të AK- Komuna Junik) | Vlerë Minimale | 11.12.2020 | 21.12.2020 | € 713.00 |
| 34 | Zhbllokimi i kanalizimit të ujërave të zeza në lagjen Bajraktar | Vlerë Minimale | 15.12.2020 | 21.12.2020 | € 745.00 |
| 1/5 | Vendosja e kamerave për siguri në hapësirat publike | Vlerë e Vogël | 07.08.2020 | 07.09.2020 | € 2,099.00 |
| 2/5 | Ndërtimi i aneksit në objektin e Komunës | Vlerë e Mesme | 07.09.2020 | 07.10.2020 | € 12,036.00 |
| 3/5 | Rregullimi i hapësirave rekreative gjelbëruese për rreth shtratit të Lumit Erenik | Vlerë e Vogël | 08.12.2020 | 08.01.2021 | € 1,623.68 |
| 4/5 | Asfaltimi i rrugës Junik- Gjocaj | Vlerë e Mesme | 09.12.2020 | 31.12.2020 | € 20,000.00 |

## X. AUDITORI I BRENDSHEM

Zyra e Auditimit te Brendshëm në komunën e Junikut funksionon në bazë të Ligjit Nr. 06L – 021 për kontrollin e brendshëm të financave publike. Në përbërjen e vetë njësia përmban një auditor, njëkohësisht auditori ka edhe funksionin e Drejtorit të njësisë se auditimit të brendshëm.

ZA fillimisht ka përpiluar Plani Strategjik 2020 - 2022 dhe Plani vjetor për vitin 2020, ku është paraparë fushëveprimi i auditimit, objektivat, kohëzgjatja dhe burimet e nevojshme për kryerjen e secilës detyrë të auditimit.

Për vitin 2020 sipas Planit Vjetor janë planifikuar pese auditime, por për shkak të pandemisë COVID-19 me kërkese te Njësisë Qendrore Harmonizuese për Auditim te Brendshëm kemi rishikuar Planin Vjetore dhe në bazë të vlerësimit kemi konstatuar qe është e nevojshëm anulimi i planifikuar për katër mujorshin e fundit "Subvencionet dhe Transferet", ku pastaj është aprovuar nga komiteti i auditimit dhe Zyrtari Kryesor Administrativ dhe është bartur për auditim në vitin 2021.

Në kuadër te këtij planifikimi janë audituar drejtorit si në vijim:

- *Menaxhimi i pasurive jo financiarë,*
- *Zyra e Prokurimit,*
- *Drejtoria për Shërbime Publike Inspeksion Mbrojtje dhe Shpëtim Komunë Junik,*
- *Drejtoria për Ekonomi dhe Zhvillim.*

Pas auditimit të këtyre drejtorive janë përgatitur Raportet finale dhe Plani i veprimit në te cilin parashihen afatet kohore për implementimin e rekomandimeve dhe janë dërguar drejtorive përkatëse dhe zyrës se kryetarit.

Siç kërkohet me Udhëzimin Administrativë MF-NR.01/2019 për themelimin dhe funksionimin e Komitetit te Auditimit në Subjektin e Sektorit Publik janë mbajtur dy takimi, por për shkak te pandemisë me COVID-19, dy nga takimet e planifikuara nuk janë realizuar.

Në përputhje me Ligjin Nr. 06L – 021 për kontrollin e brendshëm të financave publike janë përgatitur Plani strategjike 2021 - 2023 dhe Plani vjetor për vitin 2021 dhe pas aprovimit dhe nënshkrimit nga Kryetari i Komunës dhe Kryesuesi i Komitetit te Auditimit janë dorëzuar në Njësinë Qendrore për Harmonizim te Auditorëve të Brendshëm.

Statuti i auditimit të brendshëm dhe Statuti për Komitetin e Auditimit janë rishkuar, ku janë bere ndryshimet e nevojshme në përputhje me kërkesat ligjore.

Janë përgatit Raportet gjashtë mujore, TM1, TM2, dhe Raporti vjetore për vitin 2019 dhe janë dorëzuar në Njësinë Qendrore Harmonizuese për Auditim te Brendshëm ( NJQHAB ).

## SITUATA EPIDEMIOLOGJIKE DHE BALLAFAQIMI ME PANDEMIN GLOBALE COVID-19

Komuna e Junikut që nga konfirmimi i rastit të parë në vend është mobilizuar në menaxhimin e Pandemisë COVID-19, ku menjëher ka formuar Shtabin Emergjent Komunal të kryesuar nga kryetari i komunës, i përbërë nga drejtor, zyrtarë me impakt në zhvillimet komunale dhe komunitet, kryeshefi i QKMF-së, komandati i Policisë, përfaqësuesi i bizneseve dhe përfaqësuesi i komunitetit fetar. Ditët e para të Pandemisë është marr iniciativ për sigurimin dhe furnizim me miell të furrave të bukës që operojnë në komunën e Junikut nga kompania Silos në Xërxë, nga takimet e vazhdueshme të Shtabit Emergjent Komunal, 16 takime të cilat janë mbajtur nga kanë dal masa të veçanta mbrojtëse, përpos masave të Qeverisë një nga të cilat masa ka qenë edhe paketimi i pjekurinave nga furrat e bukës dhe marketet që ofrojnë produkte të tilla, janë mbajtur takime me Gastronom si kategori më e dëmtuar nga masat kufizuese për të trajtuar shqetësimet dhe problematikat tyre, si dhe në vazhdimësi janë furnizuar familjet në nevojë me pako ushqimore dhe higjientike përkrahur nga organizatat dhe shoqatat e bamiresise, ku ndihmat jan shpërndar derë më derë nga shtabi emergjent dhe QPS, si masë mbrojtëse dhe shmangie e turmave të qytetarëve. Situata epidemiologjike ka pamundësuar zhvillimin e mësimit në objeketet shkolllore, andaj gjysmëvjetori pranveror në të dy shkollat është zhvilluar përmes platfomave online, ku ka pasur angazhim të knaqshëm nga mësimdhënësit dhe nxënësit. Institucionet komunale të cilave iu është lejuar funksionimi gjatë masave rigoroze mbrojtëse nga fundi i muajit Mars-Qershor me rekomandim të Shtabit Emergjent kanë funksionuar me sportele, ndërsa komuna e Junikut ka funksionuar me staf te reduktuar, të gjithë qytetarët kanë marr shërbime dhe ka vazhduar bashkepunimi i mirë nga distanca me organizata dhe donator. Komuna ka angazzhuar kompaninë për dezinfektimin e institucioneve komunale dhe rrugëve dhe pasiqë situata epidemiologjike nuk ka shënuar rënie dezinfektimi është përsëriter prap si aktivitet. Komuna e Junikut në vazhdimësi ka sensibilizuar qytetarët për mbrotje përmes platformave të ndryshme online, janë mbajtur takime të vazhdueshme të Shtabit Emergjent Komunal për të analizuar gjendjen epidemiologjike ku shkollat kanë vijuar mësimit sipas skenareve në përputhje me rastet e të infektuarve nëpër shkolla,

kryetari ka mbajtur 9 (nëntë) takime me Këshillin e kryetarëve në kuadër të Asociacionit të komunave të Kosovës, të cilët në raste kur masat kanë qenë të ashpra bazuar në numrin e rasteve kanë reaguar dhe më pas ka reflektuar edhe qeveria përkitazi me gjendjen, vlenë të theksohet që komuna e Junikut është vlerësuar e para në përmbushje të masave mbrojtëse anti COVID dhe menaxhimin e mirë të situates epidemiologjike

LISTA E PROJEKTEVE INVESTUESE VITI 2020

Pavarësisht situatës epidemiologjike komuna e Junikut ka vazhduar zhvillimin e projekteve investuese edhepse Qeveria nga shumë projekte kapitale ka reduktuar mjetet financiare, por komuna përkundër vështirësive financiare po vazhdon zhvillimin e këtyre projekteve:

- Ndërtimi I Shtratit të lumit Erenik –Faza IV,
- Ndërtimi i kanaleve të Ujitjes: Shalaj, Gaxherr, Miroc, Jazina, prita e Katunit,
- Ndërtimi i Qendrës së Kulturës, Rinisë dhe Bizneseve,
- Asfaltimit të rrugës Junik-Sllup-Drenoc,
- Ndërtimi i shkollës fillore "Edmond Hoxha",
- Ndërtimi i rrugës Moronic-Gjocaj-Jasiq,
- Ndërtimi I rrugës-Gjocaj-Jasiq
- Ndërtimit i Shtepisë Bjeshkatare,
- Ndërtimi i mureve mbrojtëse rruga Jasiq-Gjocaj,
- Hapja, rregullimi i rrugës në stanishten Shalaj, Gacafer, Malok dhe Tropojës në Pllaqicën e Junikut,
- Rregullimi I Infrastruktuarës sanitare në të dy shkollat,
- Shkollat janë furnizuar me lënd djegëse për nxehmje,
- Vazhdoj punimet në segmentet sekondare të ujerave të zeza,
- Vazhdon hapja e rrugëve fushore,
- Mirëmbajtjen e rrugëve lokale.

PERFORMANCA DHE BASHKPUNIMI ME DONATOR

Komuna e Junikut ka mbajtur dy dëgjime publike me qytetar, por si mundësi e mirë e komunikimit interaktiv online qytetar-zyrtar komunal është shfrytëzuar edhe platforma digjitale e cila është funksionalizuar në fillim të vitit 2020, gjithashtu për shërbime administrative 24/7 tashmë qytetarëve iu është mundësuar shërbimi përmes E-kioskun.

Komuna e Junikut gjatë muajit qershor është audituar nga auditori 2020. Komuna e Junikut ka shënuar çmimin për Granint e Përformancës komunale dhe Granti për Mjedis të pastër, ku në të dyja grante ka triumfuar pavarësisht asaj që në të hyra vetanake ka pasur ngecje për dallim nga viti paraprak si pasoje e pandemisë globale. Komuna e Juniku është pjesë e projektit me USAID "Komuna transaprente, efektive dhe llogaridhënëse", ku sipas tyre komuna e Junikut në një përiudh të shkurtër kohor ka shënuar një proges të madh në avancim të përformancën akoma më të mirë, ku edhe në kuadër të projektit "Ideksi I Konkurrueshmërisë" nga USAID është vlerësuar mirë. Komuna e Junikut ka nënshkruar Memorandum Bashkëpunimi me organizatën Mileniumi i Ri, ku ky projekt do jetë iniciativ testuese për njësit e banimit në efiçencën e energjisë,

DOKUMENTET STRATEGJIKE TË MIRATUARA NË VITIN 2020

Komuna e Junikut gjatë vitit 2020 në bashkëpunim edhe me organizatat të cilat ka bashkëpunim ka miratuar këto dokumente strategjike:

- PZHK 2019-2029,
- Planin për Riintegrim,
- Plani I Integritetit,
- Planin për Menaxhimin e Mbeturinave,
- Kodi i Etikës profesionale,
- Plani për Zhvillim Ekonimik,
- Rregullorja për Kujdesin ndaj fëmijës.

Agron Kuçi
Kryetar i Komunës